

## INTERVISTË ME GANI KRASNIQIN

Prishtinë | Data: 26 korrik, 2022

Kohëzgjatja: 145 minuta

Të pranishëm:

1. Gani Krasniqi (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Renea Begolli (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## Pjesa e Parë

**Anita Susuri:** Zotëri Gani, a mundeni me u prezantu? Datën e lindjes? Vending? Diçka për prejardhjen, familjen e ju?

**Gani Krasniqi:** Quhem Gani Krasniqi, Gani Selman Krasniqi. Jam i lindur më 19... më 23 nëntor, 1950 në fshatin Carrallukë komuna e Malishevës. Natyrisht vitet e '50-ta kur kthehem mrapa tregojnë gjendjen shoqërore të kësaj pjese të atdheut tonë që ishte pushtuar, e Kosovës. Ishte gjendje e vështirë por rrjedhi nga një familje mesatare, kushtet e atëhershme gjithsesi. Bile mund të thuhet mbi mesataren e atij realiteti, ngase kuptohet në fshat je i pasur, ke qenë i pasur nëse ke pasur tokën, ke siguruar bukën, ke patur begëti, dele, lopë, bullica, të gjitha kto. Rrjedhi pra nga ni familje mbi atë mesataren, në kuptimin e gjendjes materiale, por gjithsesi edhe po t'ishte apo edhe ata të cilët kanë qenë edhe të pasur u ka munguar liria. Natyrisht çdo herë ke qenë i struktur, i rrudhur e kështu me radhë.

Shkollën fillore kom mbaruar në fshat, aty ka qenë shkolla e pavarur. Atëherë ishte me emrin, "Mustafa Bakija". Tani kemi dy shkolla, se osht' fshati i madh. Kom bërë një pushim mes shkollës fillore dhe shkollës së mesme, ngase Malisheva ishte ni zonë e thellë, zonë që disa herë e kanë bërë, e kanë zhbërë komunën e kanë shpartallue. Çdo herë mbeti në skej të Rahovecit, pjesë e skejshme e Therandës, pjesë e skejshme e Klinës. Qito dyja ishin. Kështu që, natyrisht edhe ishte interesi atëherë, i familjes jo se i ati im por edhe familja nuk e donin shkollën, nuk e donin arsimin. Po kishin edhe interesin ngase duhej dikush të kujdeset me mbi njëqind krerë dele, në moshën kur isha...

**Anita Susuri:** A keni qenë familje e madhe ju?

**Gani Krasniqi:** Kemi qenë. Kemi qenë, po. Unë kom patur ni vlla edhe tri motra. Vllau ma i madh edhe motra ma e madhe nuk janë në jetë, ndërsa i kom dy motra. Jam i martuar, jam i martuar. Kam të shoqën, zonjën, gruan dhe kam patur një vajzë e katër djem. Tani kam, do të thotë, vajzën dhe tre djem. Kam nga të gjithë ata të martuar. Janë dy mesa e tetë nipër. Kështu është tash ajo familja ime.

**Anita Susuri:** Më tregutë për babën e ju që ka qenë autodidakt, nuk ka qenë i shkollum, po vet ka qenë i interesum me përparu...

**Gani Krasniqi:** Po ndëgjo si është puna. Nganjëherë kur jemi ktu në Shoqatën e të Burgosurve Politikë, të burgosurit politikë, të përndjekurit, të vuajturit, të stërvuajturit të gjithë, nganjëherë të krijohet përshtypja me ne është nisë çdo gjë, sikurse kur kemi projektin ma të madh të kësaj pjese të atdheut, projektin e Ushtrisë Çlirimtare. Gjithsesi është projekti ma i madh, po nganjëherë kur i dëgjojmë ose kur më dëgjoni mu ma së miri, se jom pjesë e të gjitha ktyne përpjekjeve nganjëherë krijojmë përshtypjen që gjithçka ka fillu nga UÇK. Jo, do të thotë. Ngase ishim të pushtuar, ngase ishim të ndarë nga trojet tona, ngase ishim të nënshtruar ni padrejtësie edhe të pushtuar si komb gjatë edhe pastaj ripushtimi, çdo herë ka pasur përpjekje.

Kështu që, për të mos shkuar më tej, falë atyre përpjekjeve, falë atyre projekteve, bie fjala, ne çdo herë kemi pasë udhërrëfim projektin e Lëvizjes Kombëtare, Lidhjes së Prizrenit. Ajo ka qenë, do të thotë, ni lidhje e fuqishme, ajo ka qenë ai projekti ynë të cilin e kemi pasë si orientim. Po vazhdimisht ka patur përpjekje, vazhdimisht ka patur sakrifica, vazhdimisht ka patur burgje, vazhdimisht kanë munguar njerëzit të pjesëve të pushtuara të atdheut.

Në kohën kur i ati im, Selmani, ka qenë i lindur në '12-tën, do të thotë, në vitin kur osht' shpallë pavarësia e asaj pjese, tani Republika e Shqipërisë, ka qenë ai brez. Ai brez, do të thotë i përket brezit të lëvizjeve. Pastaj kur jom rritë, që janë marrë ekskluzivisht me shpërndarjen e literaturës, qoftë nga Shkodra, qoftë nga Shkupi nga edhe kanë qenë këto degëzime. Kështu që edhe atëherë si rini, janë këto të shkruara, kanë bërë ni shoqëri "Drita", përmes së cilës janë përpjekë për t'i paraqitur ato ide të tyre. Por, gjithsesi duke qenë të kujdesshëm. Si pasojë e kësaj, natyrisht edhe baba im ka qenë tri herë i burgosur por me burgje natyrisht jo të gjata.

Pas luftës përmendet vitet, menjëherë pas luftës, nejse i ka mbetur Rankoviqit se ktu kanë qenë të gjithë. Ne ju kemi bashkangjitur, kjo pjesë e atdheut i është bashkangjitur Nazi fashizmit. Natyrisht për ata edhe i kanë kap armët, aty është derdhë gjak për ta luftuar Nazi fashizmin. Pjesë kanë qenë babi im dhe bابتë e tonë që të gjithë të tjerët. Po u shliuan. Do të thotë, garant ka qenë ajo Konferenca e Bujanit e cila osht' majtë në Tropojë, në Bujan të Tropojës. Por, megjithatë ishin raportet të cilat ishin dhe ju nënshtru padrejtësisë. Ata njerëz që natyrisht kanë kapur armët, kanë luftuar, kanë investuar edhe çdo gjë për të arritur, vërtetë për të hjekur Nazi fashizmin dhe për të vendosur, se kështu është thirrë ky populli.

Natyrisht u tradhëtua nga partia komuniste e Titos, Jugosllavisë. Aty kanë qenë ato pasojat. Natyrisht njerëzit nacionalistë tani etiketoshin si të djathtë. Vërtetë kanë qenë të djathtë por nuk e kanë mësuar e djathtë e majtë brezit para, para tontit. Atyne ju ka interesuar çlirimi edhe do të thotë çlirimi i kombit dhe bashkimi i kombit. Por, atëherë i kanë trajtuar kështu dhe i kanë marrë si shumë të tjerë, sikurse dihet edhe procesi i Prizrenit, sikur që dihet figurat të cilat kur janë pytur natyrisht në Prizren se, "Kah ka qenë masa dhunshme", sikur që ishte në '89-tën a kur, '89-tën, ktu kuvendi, kuvendi që ishte ma i besushëm megjithatë nuk... edhe pushkatohen.

Çka dua të them? Dua të them që me këtë si unë nuk më bijnë nga qielli, nuk ka mbi atdhe dashuria në familjen time tek unë apo nga unë, nuk ka lindë me mu. Po ka lindë me breza të cilët kanë ardhë ashtu edhe si ne si brez, si ne si brez, natyrisht kemi patur, e kemi patur kto sheshet pushimore, sikurse janë do shkallë të ngritura kanë ngritur aq sa kanë mujtë derisa kemi filluar nga ni shesh për të ecur përpara.

**Anita Susuri:** E po më intereson kto organizatat, baba juq që ka qenë pjesë e luftës, a kanë qenë të ngjashme me kto organizatat e mëvonshme ilegale?

**Gani Krasniqi:** Ndëgjo shoqëria Drita atëherë ka qenë shumë e shtrëngume çështja. Ajo ka funksionu kështu në emër të një shoqërie të kuptimit të kulturor për ta shpërndarë. Por, në emër të asaj, nën petkun e asaj ka marrur edhe natyrisht tani kanë shpërndarë literatura, të cilat natyrisht i janë dashtë lëvizjes dhe janë konsideruar të ndëshkueshme, të ndaluara dhe kështu. Por edhe kanë mobilizuar, kanë mobilizuar. Tash dihet ky brez është të cilët janë dalë në Besjanë, Podujevë dhe ju kanë kthyer dhe është dhënë lëvizja e Shaban Polluzhës, e vullnetarëve, të cilët natyrisht se e kanë pa se u tradhëtunë. Kjo është domethënë, format kanë qenë të ndryshme varësisht nga koha, varësisht nga përkatitjet, rrethanat të cilat kanë qenë, pavarësisht edhe shtrëngimet të cilat kanë qenë.

**Anita Susuri:** E që thatë babai ka qenë pjesë e Luftës Nacional Çlirimtare, a ka qenë në radhë, domethënë, në ushtri apo...

**Gani Krasniqi:** Jo, jo, atëherë, atëherë për të qenë, unë po e thom, se kjo frymë e atij brezit intelektual që e kam të rujtur bie fjala deri te... atje e pashë në koridor [i drejtohet personit nga dera], deri në Llap e ki këtë, Ramë Govarin. Do të thotë është ai brez, kanë shpërndarë. Ky brez nuk osht' përgatitur për të mbetur nën Jugosllavinë atëherë, ka pytë, i ka marrur si partizanë pastaj ju kanë bashkangjitur si vullnetarë. Por, baba është ajo pjesa e të cilëve tani vullnetarëve të Shaban Polluzhës. Atëherë kanë shku te Bajraku i Astrazubit, Bajraku i Rugovës, Bajraku... qysh kanë qenë bajrake qysh i kanë çue. Aty kanë bërë rezistencën, që do të thotë, ka qenë edhe i afërt me shtabin e Shabanit të cilët kanë qenë. Për këtë ka patur ato pasoja.

**Anita Susuri:** E këto ngjarjet, ngjarjet politike, me thanë, që kanë ndodhë në vitet e '60-ta në periudhën e Rankoviqit, si kanë ndiku te familja e juq? A keni ndonjë kujtim diçka?

**Gani Krasniqi:** Kam kujtimet, kam kujtimet. Dihet ato vite ishin, nëse kthehemi mrapa, se osht' do të thotë... mjetet për të rezistuar, për të kundërshtuar kanë qenë ato që t'i ka ofruar koha. Mundësitë kanë qenë ato që t'i ka ofru koha dhe potenciali ka qenë ai që e ke patur. Unë e mbaj shumë mirë mend, kështu edhe pse i vogël, i ri çka është biseduar në odë. Unë, bie fjala, në odën time e kom dëgju babën tim, i kom dëgjuar gjeneratën e babis tim duke thënë, "Ej Ramë Bllaca është duke ndërtuar kullën...", ka qenë shenjë Ramë Bllaca. Do të thotë, ai që e ka ndërtu kullën nuk shkon për Turqi. "Mustafë

Rahoveci, ka mbjellë krejt tokën rrush”, hardhi rrushi, për të treguar... edhe kto forma i kanë përdorë. Kështu që, unë e maj mend si sot.

Unë pranoj, për t’ju përgjigjë se kanë çu njerëz për të ardhë, për të thanë, “Po krijojmë kushte, shkoni atje, ne kemi...” ne kemi njerëz miq edhe që janë familje të mira të Drenicës. Po gjysa e familjes ka shku, gjysa ka mbetur ktu. Që ka qenë vllai i njëni prej tyne ka qenë pjesë e kësaj lëvizje, por ka shkuar. “Unë ma mall”, po flas me gjuhën e tyre, “e bëj fmitë e mi të shkrihen sesa t’i marrë t’i coj atje. Kta e don Serbia”. Kto i mbaj mend do të thotë. Këto forma kanë qenë forma të organizimit të rezistencës atëherë për mos t’u shpërngulë Kosova.

Do të thotë, e kanë pasur të qartë se ata dojnë ta pastrojnë Kosovën nga shqiptarët. Kështu që, pa i hyrë pastaj aksionet të cilt kanë qenë në emër të, ajo ka qenë minë e pas luftës, tepricave që i kanë thanë, vishakut [Srb.: *višak*, tepricë]. Edhe ajo ka qenë, ka qenë projekt i bërë. Kolonializimi, unë tash kta kolonializimin nuk e mbaj mend. Unë e mbaj mend kolonën kur kanë qenë, po unë e mbaj mend çka osht’ folë, si kanë ardhë, tek kanë ardhë pa përzi këtë tani që kam lexuar.

Tjetra, tepricat, e thashë. Armët, aksioni i armëve, kjo është bërë pikërisht... ni pjesë e këtij aksioni ka pasë filluar edhe në vitin ‘97, ‘96-‘97 ktu. Po ish realiteti tjetër ishte. Vinte ta lypte pushkën, “Jo, gjoje”, s’e gjoje, të thirrke, të rrehte, të malltretonte e sene edhe ti tash ku, kah, ku sytë atje këmbët. Kështu ka qenë. Do të thotë, këto janë gjëra që çdo njeri i brezit tim ka qenë, ani se ka qenë fëmijë po i ka, i ka përjetuar duke dëgjuar ose duke parë familjen të shqetësuar, të struktur, kështu.

Atëherë kanë hjekur natyrisht familjet nacionaliste edhe familjet e fuqishme që kanë qenë. Nëse një familje e fuqishme ka ikur, ka qenë edhe si shembull. Kjo rastësisht Ramë Bllaca është në kujtesën apo pjesë e historisë tonë, ose Mustafë Rahoveci e figura tjera. Se ai me shembullin konkret ka deshtë të tregoj, “Unë ktu jetoj”. Kulla, vneshta e kështu me radhë.

**Anita Susuri:** E a ka pasë ndoshta në familjen e juaj ose në rrethin që keni jetu ndërhyrje të policisë ose forcave të rendit me thanë? Për ndonjë rast ose për me marrë babën e juaj në pyetje ose diçka?

**Gani Krasniqi:** Baba jem tri herë ka qenë pikërisht për këto çështje i etiketuar si nacionalist, si nacionalist. Se ne kemi qenë të lidhur, jo që kemi qenë ne si familje, po ati im ka qenë i lidhur me familjen e Rifat Berishës se kemi pasë miqësi. Ata rezistun, Rifati u vra. Edhe tash natyrisht, natyrisht ti ke pasë miqësi, kanë ditë, ti ke qenë i lidhur përmes tyre. Natyrisht për këtë edhe ka qenë, edhe ka qenë tri herë i burgosur nga gjashtë muj, po ka arritur ku ta di edhe ka pasur edhe kujdesi, interesimi, vllazërit kanë qenë, kanë qenë të fuqishëm në kuptimin e kohës. Të fuqishëm edhe materialisht e sene edhe atëherë ka qenë korrupsioni. Kur mund sot ta blesh lëre më atëherë (buzëqesh). Por sidoqoftë kështu ka qenë, do të thotë.

Unë të atin tim nuk e mbaj mend me dhomë, me dhomtë e tij natyral. Dhëmbët që i ka patur, nga malltretimet... se kanë qenë, bie fjala, Kadri Minushi, Kajtaz Ramadani i Kijevës, që s'ka pranuar do të thotë, në Prizren është pushkatuar. Kadri Minushi ka qenë i dënuar për jetë por tani e kanë falë, 13 vjet i kanë majtë. Që kanë qenë, ky ka qenë ai klubi. Sadik Meta i Potërkut aty te Llapushniku. Mehmet Shabani, Mehmet Krasniqi, Shabani, kto kanë qenë vijat. Baba i Nexhmijës Pagarusha, Vesel Pagarusha ky ka qenë ai rrjeti. Unë i kom kështu të rujtun edhe kah kanë ardhë. Edhe kah ka ardhë literatura nga Shkupi knej edhe ka ardhë nga Shkodra në Gjakovë që ka depërtue edhe kta janë marrë me shpërndarje. Ka përcjellë, i ka vëzhguar natyrisht.

**Anita Susuri:** Vendi ku jeni rritë ju, thatë që ka qenë si pjesë ma e thellë. Po qysh ka qenë, për shembull, me jetu në qat' vend në kontekstin e zhvillimit domethonë edhe kulturës nifare forme po edhe pjesëmarrjes në shoqni në tansi, mbajtjen e raporteve me vendet tjera përreth?

**Gani Krasniqi:** Ndëgjo, tash duket e pakuptimt nëse shikon edhe nëse nuk e njeh për së afërmi, se për afërsisht Malisheva është Malisheva që administron krahinën e Llapushës, kështu quhet. Është për afërsisht në qendër të Kosovës, është edhe në udhëkryqin sot të Kosovës. Edhe qysh vend i skejshëm e qendër të Kosovës në udhëkryqin e Kosovës? Udhëkryqi është sot se atëherë nuk i ke pasë rrugtë dihet. Kështu ka qenë. Edhe kolonët kur i kanë pruar kanë ikur nga ktu ma herët. Pse kanë ikur? Për shkak të mungesës së perspektivës, kjo është një.

Ki disa elemente, ashtu si i ki në disa zona të thella të rujtura të virtyteve tona kombëtare. Mikëpritja, për shembull, në zona të thella në Rugovë i ki ma t'rujtuna se atje s'kanë depërtuar. Edhe në Malishevë i ke patur deri vonë, ngase s'ka qenë i interesuar, s'ke patur asgjë. Po edhe natyrisht se ka qenë i prapambetur tash. Bie fjala, unë kom patur kushëririn tim të largët që ka qenë nip i Ramë Bllacës. Po ai ka qenë brez i ktina, Zajmit, Gazmend Zajmit që ka kryer studimet, ka kryer studimet atëherë. Po falë lidhjes me Ramën, se edhe djemtë, edhe Qazimi i Ramës, edhe Ademi i Ramës, edhe ky Fazlia qysh e ka pasë ky Fazlia... Rama i ka shkollu, i Bllacës. Ka qenë në Lidhjen Komunistën. Rama i ka shkolluar, tash edhe ky ka arritur.

Përndryshe, hiç ata, ka jetuar, është i ndjerë, ka jetuar në Prishtinë, hiç atë unë i përkas brezit të parë të fakultetive. Tash ki ti parasysh, përkundër ni babë i lexuar, ka pasë njeri fakultetin, përparimtar e sene megjithatë unë pas katër vjete kom fillu shkollimin e mesëm. E ke ti parasysh. Pse? Pos atij interesi që thashë preket tani edhe interesi tjetër, duhet ta mbash, duhet ta çosh në Prizren, duhet ta çosh në Prishtinë, duhet ta çosh në Pejë, besa edhe në Rahovec. Në Rahovec ka pasë shkolla të mesme, Malisheva s'ka patur. Në këtë kuptim, kjo ka qenë do të thotë ajo.

Por edhe pastaj gjithnji ka vazhduar edhe ajo që është bërë me shurjen e autonomisë të Kosovës në vite të '89-'90-të kur kom qenë në burg atëherë e kanë shuar. E patëm bërë Malishevën komunë edhe atëherë e patën shu, e patën zhbë. Tani e patën bë në '86-tën, tani e shujtën tash kur e shujtën autonominë. Çdo herë ka qenë ç'është bërë. Ka qenë nifare liberalizimi me Kosovën edhe e kanë bërë

komunë. Ka qenë ni diçka *tak* {onomatope} e kanë shtrëngu. Me ni mënyrë i thonin atëherë, “Ajo Shqipnia e vogël”, nëse administrata edhe në atë kohë... s’ka pasur serbë vetëm në Kijevë kanë qenë ni pikë... është majtë shqip. Kështu ka qenë.

**Anita Susuri:** Thatë që shkollimin e keni vazhdu mas katër vjete. Qysh jeni, si me thanë, qysh keni rifillu me shkollim domethonë?

**Gani Krasniqi:** Puna e parë... po, po, e qartë, e kom pytjen shumë të qartë. Çështja e parë, unë në të vërtetë kom ndërpre por nuk kom ndërpre pasionin tim për lexim edhe bindjen time se unë duhet ta mbaroj, duhet të shkollohem, duhet të arsimohem, kjo ka qenë. Unë edhe me dele kur i kom çu delet kom lexuar. Natyrisht në çastin kur e kom bind, e kom bind vetën se duhet gjithsesi atëherë ju kom thanë, “Unë do të shkojë në shkollë”. Po ti s’kishe lekë. Kom kërkuar nga axha të mi gjen si me thanë tash 500 euro, ku ta di.

Po ishte fyrje ti me dalë me shku në gurbet për familjet që kanë qenë të fuqishme. Ishte pak fyese se është marrë për varfnjak, po varfnjak kemi qenë krejt në fund të fundit. Shkojnë në gurbet, ki tokën, ki kta, ki ata. Kom marrë hua, kom shkuar në Slloveni, jam pavarësuar materialisht. Kanë hapë paralelen e ndarë në Rahovec, Rahoveci në Malishevë, paralele e ndarë. Edhe atëherë unë jam ardhë në shtëpi në gjysmë-vjetor. Kisha lekët. I thom babës, “Unë do të shkoj në shkollë”.

Paraprakisht ni, se a p’e sheh harrohet, paraprakisht kom ikur niherë para se me këtë këtë, por nuk isha i pavarur materialisht. Nga i kom lanë delët, nga Caralluka kom shkuar në Prizren, atëherë nuk kom ditë me ia ra trup. Merre me mend kom shku në Rahovec, kom dalë në Xërxë e kështu, xhaden... s’kom ditë as me ia majtë me dalë në Krushë, a din pak. Po mos me shku, jom shku jom regjistrua pasiqë është kry më kanë shti në [Shkollë] Normale atëherë. Nuk e di, e kom të shkrujtun po drejtori i gjimnazit ka qenë, kishte qenë i krishter, e kom të shkruar. Kishte qenë te drejtori m’kanë shti.

Drejtori kur e pa gjendjen, formalisht me dhanë provimin kishe, se i tregova gjendjen. Kom dhanë provimin, jom regjistru. Drejtori m’ka çuar e ka marrë motrën në telefon se mi shadërvan ku osht’ ajo e kishte pasë shtëpijën. Ka dalë motra m’ka marrë, a disha unë, s’disha çka është shadërvani a din po tregoj kështu shumë sinqerisht. “Ai kroni”, tha, “që qet”, “Po”. Jom shku, ka dalë motra m’ka marrë, “Ktu do t’jeshë”. Po erdh axha më mashtroi për me rujtë atë interesin familjar edhe u binda. “Po të çojmë në Pejë, e kem, kta, kta...” E pashë që s’ka pastaj ika edhe shkova siç thashë në Slloveni.

Pata siguruar [mjete financiare], erdha. U hap në Malishevë paralelja e ndarë erdha në gjysmë-vjetor se kisha, dojsha, kisha gjetë punë për të siguruar mjetet. Kur vi thom, “Unë do të shkoj. Po, unë”, thashë, “do të shkoj. Kom vendosë”. Por gjysmë-vjetor, tani unë kom kompenzuar, ngase kom lexuar vitin e parë e kryva për gjysë viti si shkova më pranunë. Vitin e dytë isha krejt me pesshe se kisha, do të thotë, kisha lexuar edhe lexosha unë edhe vitin e tretë vet profesorët më thanë, “Duhet të vish në”, e pata

marrë me korrespondencë, ish privat atëherë që jepnin. Pastaj vitin e katërt e kam kry në Rahovec për shkak se ktu nuk ishte hapur viti i katërt, e ke parasysh?

Për dy vjet e gjysë kam mbaruar gjimnazin. Do të thotë, megjithatë e kom shkurtuar për ni kohë dhe pastaj kam regjistruar Fakultetin Ekonomik. Kam përfunduar fakultetin në '77-tën, në fund të '77-tës, dikun aty. Kom, me të mbaruar fakultetin jom punësuar në Feronikel, drejtorja ka qenë ktu ku osht' tavalla, tash osht' ni ministri m'doket, s'di cila osht'. Dhe deri në '81-tën kur edhe më kanë arrestuar.

**Anita Susuri:** Du m'u kthy pak mrapa te do detaje që i përmendet, që thatë keni shku në Slloveni. Qysh keni shku në atë kohë? Me tren apo si keni shku në Slloveni?

**Gani Krasniqi:** Po, me tren, me tren natyrisht. Gjeta përafërisht 500, si me thanë 500 euro, çka janë konë ato atëherë, dinarë, a çka janë konë? Natyrisht, megjithatë atëherë kish gjithandej njerëz tonë, shqiptarë kudo ishin. Kish edhe kusheri e sene. Shkoj, gjej punë. Po gjej punë, unë punoj privatisht ngase merrsha punë. E goditsha punën, e merrsha punën, e merrsha ni teknik u konsultojsha, i kryjsha puntë. Unë fitojsha sa ata dhetë, 15. Me siguri në vlerë të 50 mijë, 50 mijë euro kur jom ardhë në shtëpi i pata prur. Pastaj ua pata dhanë, ua pata dhanë edhe kështu. Kështu ka qenë.

Çka dua të them, '68-a, se lidhemi me këtë, '68-a unë nuk i, nuk i kom përkit organizimit. Në '68-ën kemi qenë thjeshtë simpatizantë, kemi manifestuar me simbole. Rrypin e orës nëse kemi pasë, nëse s'ke pasë e ke ngjitë naj rryp kishe ki orë, naj orë të vjetër kuq e zi, naj këmishë kuq e zi, naj kështu shall kuq e zi edhe natyrisht ishin këngët. Kishte fillu literatura por nuk kishte siguri brezat ma të pjekur edhe ishin të paktë atëherë, ishin të paktë për të, se ishte edhe rreziku i madh. Po '68-a ka qenë ajo pjesë që kemi manifestuar atdhedashurinë tonë.

Atë që kemi dëgjuar nga babët tonë, ktu osht' baza. Familjet pastaj është universiteti ai i cili ka kryer, do të thotë, se aty u bashkohim të gjithë të ri e të reja nga të gjitha viset shqiptare të pushtuara. Natyrisht, kishim orientimin edhe të njerëzve të gjallë, Baca Adem ka qenë ai udhërrëfyesi ynë. Nuk e mshefi se kështu ka qenë Republika e Shqipnisë, televizioni shqiptar, marrëdhënia, ndërtimet e marrëdhënies të shtetit shqiptar me Kosovën edhe përmes Jugosllavisë, por me Kosovën.

Ardhja e profesorëve në ligjerim, ardhja e shoqërive kulturo-artistike, ardhja e ekipeve, grupeve sportive... atëherë veç filloi të mbarësohet edhe të shpërndahet do të thotë, të rritet radha edhe në ni mënyrë kjo ishte edhe ajo që bëri. Pastaj, unë kuptohet, i përkas pjesës së organizuar aktive të '81-tës. Pse isha në punë, unë kurrë s'i kom shkëputë [aktivitetit]. Bile, bile unë i kom patur atëherë lidhjet me konviktin, ni konvikt e gjysë kanë qenë femra. Me to kam pasur, ia korruptojsha, lehtë, se atëherë ka qenë për t'hyrë, duhej t'hyrë të dileve për t'i vizituar shoqet e kështu me radhë, familjarët.

Por, do të thotë atëherë kom qenë pjesë aktive e organizuar, pjesë e lëvizjeve dhe kështu erdhëm te '81-ta, që jo rastësisht, dikush e quan kryengritëse, që ishte kryengritje. Revolucion, ishte revolucion se



përmbysesh çdo gjë, përmbysesh çdo gjë. Mobilizoi çdo gjë, nuk ishte vetëm i studentëve, te studentët u nis po ishte e të gjitha, ishte e punëtorëve, ishte e fshatarësisë. Edhe ne kemi patur detyrë jo vetëm këtë komunikimin e drejtpërdrejtë apo që thuhet me folë me vehten, me studentin, me rininë, me intelektualin. Po atëherë kemi patur edhe detyra, do të thotë, për të krijuar lidhje. Te punëtortë e Ramiz Sadikut, te punëtortë e KEK-ut. Atëherë ishin shumë, shkojshim pijshim çaj, kadal dale e gjejmshim njerin, e bojshim rrethin, u mobilizojshim edhe kështu ka qenë ajo.

Po gjithnji, gjithnji rol jo, jo rol po të rëndësishëm ka luftë edhe shteti shqiptar. Unë, bie fjala tash, ne jse kjo edhe dihet për kta kam qenë edhe i akuzuar, kanë qenë edhe në raporte, kom patur raporte të lidhura sikur kanë pasur lëvizja, njerëz të caktuar të lëvizjes edhe me shtetin shqiptar. Unë kom organizuar edhe kom shkuar, kom vizituar në emër të turizmit, të organizuar që bëhej atëherë po gjejsa njerëz të sigurt, shëtishim. Tri herë nga 15 ditë kemi qenë, unë po që i kom çu edhe grupe tjera.

## Pjesa e Dytë

**Anita Susuri:** Deshta me u kthy pak me folë për '68-ën. Cilat kanë qenë, për shembull, bisedat mes juve? Shoqërisë? Të rive në atë kohë? A kanë fillu atëherë ma shumë me i tregu idetë e tyre? A ka ndodhë edhe ma herët?

**Gani Krasniqi:** Unë e thashë edhe në fillim kur e thashë, fola edhe gjithnjë duke menduar se atëherë kam... edukata ime apo atdhedashuria ime ka qenë e një të riu simpatizant, militant, militant është pak e, e... militantizmi është kur je i brumosur po je skajshmërisht i brumosur. Por, deshte e s'deshte në çdo cep të pjesëve të pushtuara, sidomos në zona të thella ti s'ke patur qare se të ka prekë, të ka prekë. Për shembull, e ki rastin në Carrallukë, në vitet e '60-ta, s'e di tash, '61, '62, tash për besë nuk e di. Muharrem Thaçi, Muharrem Haziri ka vra Pero Shytarin, kështu osht' qujtë, ni malazez që ka qenë drejtor i postave të Kosovës. Pse e ka vra? Se në kohën e tepricës, tepricës, që i kanë thanë, tepricës, po çfarë teprice po në kohën e plaçkitjes të bereqeteve në emër të tepricës i është vra baba i tij, që thuhet, ne jse ktu futen në art [poezi, proza] e sene, po është vra për ni thes mill, për ni thes grurë.

Tash, në vitet e '60-ta në kulmin e tyre ky ka vra mu te [Hotel] Unioni ktu, ka marrë hakun. Tash, ti vetvetiu, pse? Se ia ka vra Perën. Kush është Pera? Njeri i UDB-së. Pse? Na e mor... ka thanë, "S'kom bre, s'kom. As për fmi s'kom bukë", edhe e ka vra në zyrën e tina, në fshatin Drenoc. Për ata thom, vetvetiu s'ke patur, s'un i ke ikë, s'un i ke ikë se ke parë babën, nënën, kushërinin, dajën, kudo që ke shkuar dhe kudo që ke shkuar. Do të thotë, kto kanë qenë vitet që kudo që ke shkuar e ke parë tim, sikur tash. A e ke pa me fmitë e tonë kur rrin? Veç qysh me ikur jashtë. Atëherë qysh ta lshojmë Kosovën se s'rrihet. Pse? Ta ka futur... atëherë ka hyrë Serbia me forma të ndryshme.

Me këta dua të them, unë mund të them që, po nuk e them ni të vërtetë, e them se e them se unë kur osht' burgosë në '64 Adem Demaçi... por jo vetëm Adem Demaçi, ki rastin e Gjakovës, ki rastin, për shembull, që i kom njoftë të Suharekës, ki rastin e Prizrenit, që të gjitha. Atëherë ti edhe nëse ke folë diçka, ke folë në ni mes të besueshëm. Por, nëse ke qenë i ri si puna ime edhe ke folë në rrethin, ty të ka duru për shkak se po e din se ti je i biri i filanit, "Je djali i Selman balit", a din, "Hec", thotë, "Adem Demaçi. Po me shkollë po, po ka kush mendon për aty. Kemi Mahmutin, kemi Fadilin", se kështu ka qenë realiteti. Ai ju ka dhimtë, e lëre më aty kur ka qenë. Plus e kanë patur frikën. Me këtë dua të them, temat kanë qenë këto sa kemi mujtë për t'i kapë.

Për ta ngjallë kanë qenë të burgosurit, të kanë disiplinë pak, të kanë tutë pak, 'Çka po ndodhë me mu?' Jo me mu se ne kemi qenë të ri, po po flas me masën që janë konë ma të pjekur. Apo kanë disiplinuar pak ata që kanë qenë kanë nejtë struktur. Se unë e di njerëz që i kanë fut... njerëz që i kanë fut në burg vetëm që vetëm që ka qenë... e di që edhe e kanë vra. Në kufi e kanë çu e kanë vra. Por, atëherë ka filluar, kur ka filluar edhe ktu ka filluar të thuhet, përshpëritet, zhylatët, të shpurdhet, të preket... pas ramjes së Rankoviqit, "Kosova Republikë", por flamuri. Megjithatë edhe aty kishte hile por ishte sakrificë, ishte protesta, ishte e shtypur, por megjithatë arriti universiteti, arriti flamuri të jetë kështu. Tash këto sado pak me përpjekje edhe sado të jetë e madhe, ti kur e shënon ni rezultat ai të trimëron. Do të thotë, sikur puna e notit, të shtin për të shkuar.

Ne... po kjo ka qenë '68-a. Unë po thom, pa '68-ën nuk ishte edhe '81-ta kjo që ishte. Ka kushtu e sene po ne kur e kemi bërë diçka, kur kemi filluar të organizuam ne kemi menduar çdo herë kemi pasur parasysh sikur të ishte Baca Adem çka do të bënte. Po natyrisht secili tani i ka pasur ata Baca Ademtë që e kanë njohur ma praktikisht. Unë s'e kam njohur, e kam njohur vetëm si emër. Kjo, tash nuk e di sa dita me thënë, sa, po kështu po flas si e kom pa, si e kom përjetu edhe çka thuhet. Baza e djemëve dhe vajzave të shëndosha, të shëndosh, jo të shëndosh po në kuptimin që po flasim, të dashurijen ndaj atdheut, ndaj lirisë ka qenë me këmbë të mbarë ka qenë shtëpija, familja. Kështu ka qenë.

Shkollat e tona ti i ke pasë, me recitu, çka po di qysh janë konë ato "*Bitka na Neretva*" [Srb.: Beteja e Neretvës] qysh janë konë ato, a din, kështu ka qenë. Po flas për ato... edhe Vllaznim-Bashkimi. Kjo ka qenë, vetëqeverisjen, socializmin këto kanë qenë, në shkolla. Tash shkolla kanë qenë krejt... edhe në shkolla ke patur që profesorët ku kanë pasur besim kanë mësuar edhe nxënësit.

**Anita Susuri:** Ju në Prishtinë keni ardhë diku në '74-tën ndoshta? Apo?

**Gani Krasniqi:** Qaty, për besë, '73-'74.

**Anita Susuri:** Ka qenë edhe kur...

**Gani Krasniqi:** Po. '73-'74, '73-'74.

**Anita Susuri:** Qysh ka qenë Prishtina për shembull? Edhe si qytet po edhe situata?

**Gani Krasniqi:** Ka qenë, të jemi të singertë ktu frymëmarrja ka qenë tjetër. Frymëmarrja ka qenë tjetër. Ka qenë kënaqësi të jesh student, ka qenë kënaqësi... përkundër kushteve që kanë qenë të vështira. Ka qenë kënaqësi të jesh pjesë e ni organizimi që mendon, që mendon shqip, mendon diçka ma shumë sesa që e ke detyrë për të bërë. Po edhe brenda, edhe brenda subjektit shqiptar, qoftë personel, ke patur. Të jemi të singertë se ke patur struktura të cilat natyrisht ti je dashur të kesh kujdes. Besa ka patur edhe që ia kem lshuar, kur e kemi pa, jemi organizu... i riu, çka thojnë. E kanë ata serbët që thojnë *mladost ludost* [Srb.: Rini çmenduri], që thojnë, po kështu e kanë. I joni nuk i bon, ai idealisti, idealisti, idealisti, do të thotë, kuptohet nuk është, e ka ni shkallë mbi atë se nuk e sheh vetën, e sheh atë çka ka ideal.

Po megjithatë, atëherë përkundër presioneve që është bërë në forma të ndryshme. Qe veç po e marrë ni shembull, bie fjala, kur kemi shkuar në konvikte te shoqet tona, te motrat tona, te koleget tona, qysh i kemi pasë lidhjet, ke patur... se kështu ishte, s'kishte javë, mos të thonë ditë që s'kishte koncerte. Krejt çka janë konë ato, Lepa Brena, do Zdravko Çoliviqa, Petkoviqa janë konë atëherë. Tani ishim në disproporcion me pjesën, me republikat e tjera. Çka dishim. Popull, megjithatë kishe ato posterat e tyre. Thojke, vajza, thojke, p'e thom kështu, thojke, "P'e maj kta", thojke, "se i fejuari im, ngjan në të fejuarin tim". Për të ardhë te tjera ose, "I fejuari, i dashuri", e kështu me radhë. Po edhe aty tani ne kemi patur edhe asi veprime, ku 25-ta [Maji] ka qenë [Salla] 1 Tetori, ku mbanin kto organizime shkonim aty edhe e prishim. E bojshim rrëmujë, sabotojshim sene natyrisht na merrshin, na futshin sene... në këtë kuptim.

Por, megjithatë, megjithatë ka qenë kënaqësi ngase ishte mundësia e komunikimit. Do të thotë, të gjithë hapësirës shqiptare për të gjetur shokë, shoqe. Ishte organizimi pak ma i kujdesshëm po rinia ma nuk e man. Falë kësaj mundësie edhe erdh si tash... 11 marsi [1981], 11 marsi osht' vërtetë ka filluar me kërkesa sociale. Osht' e vërtetë se ka fillu, ai që e njej kta mirë. Ai që e njej 11 marsin del Ali Lajçi përpara, dalin studentët. Por, ne kemi qenë pas tyre. S'po di... ne kemi qenë pas tyre. Organizimi i msheftë ka qenë pas tyre, mas tyre. Se mu më kanë arrestuar me 26 [mars], kam qenë i pari i arrestuar. Në zyre janë ardhë më kanë marrë. Më kanë përcjellë ata.

Tani ai që i njihte '81-shen, se tani u afriu lëvizja, se lëvizja ka qenë te studenti, edhe te naj profesor aty-ktu. Për shembull, e kem pasë Ukshin Hotin, a din, po e marr shembull. Ose kanë depërtuar, ose te klasa punëtore atje, ka patur. Tani aty, se Hydajeti ka qenë në ilegalitet ktej edhe tani ka dalë lëvizja edhe e ka marrë në dorë edhe dulë masa. Natyrisht ktu është jo rastësisht... pranvera e '81 është... janë dy lëvizje ma të fuqishme në Europë, pranvera e '81 dhe Solidariteti polak. Kto janë ato që e trembën dhe nga aty nxuni në thu Jugosllavia. Kështu kanë shku.

**Anita Susuri:** Para se me vazhdu për '81-tën, po du me ju pytë për vizitat në Shqipni që i përmendët...

**Gani Krasniqi:** Po. Vizitat në Shqipëri, ne thamë, e thamë atë mos të harrojmë, s'mund të harrojmë edhe s'duam ta harrojmë, shteti shqiptar ka shfrytëzu të gjitha mundësitë për fat të keq tonin kur sot jemi shtet i pavarur, shtet i pavarur sovran janë kufijtë e hapur. Nuk i kemi ato raporte të ndërtume të bashkëpunimit në arsim, kulturë, sport, art e këto çka janë. Atëherë, do të thotë, këtu ke patur, unë krejt profesorët Rexhep Mejdun e te poshtë që kanë qenë... unë kom shku kom dëgju ligjeratë në fizikë edhe s'jom konë student, kom shku kom dëgju ligjeratë në mjekësi, s'jom konë student, po edhe nëse jom konë student ma përpara, jom konë student i ekonomikut. Vetëm për t'u njohur.

Ardhja e grupeve, ardhja e profesorëve, ardhja e grupeve shoqërive artistike, ardhja e ekipeve sportive të ndryshme që kanë qenë atëherë. Atëherë luhej shumë ky, volejbolli {shpjegon me duar formën e topit} po edhe hendbolli, femrat. Të gjitha kjo ngjalli. Nga aty, tash natyrisht kanë qenë edhe njohjet, se kuptohet vinin në secilin ekip, në secilin... po kishte edhe profesorë që ishin pjesë, që ishte me misionin e vet. Kanë filluar edhe njohja, do të thotë drejtpërdrejtë edhe me ambasadën, me njerëz të ambasadës shqiptare edhe kështu. Po kemi pasë edhe lidhje nga jashtë, se lëvizja ka qenë me shtete tjera atje. Në Austri ka qenë shumë lidhja e shokëve tonë që kanë qenë jashtë. Nga aty tash natyrisht kemi biseduar për mundësitë, po jemi përpjekë natyrisht për të dhanë njerëz që vërtetë e dojnë Shqipërijën. Por edhe ajo ka patur efektin e vet.

Ni shembull, bie fjala, edhe si osht' manifestuar propaganda për ta dashur Shqipërijën. Për shembull, kom ble dhjetë, 15 krrude, shtaga për pleq, a din, p'e marrë si shembull nashta i kisha ble të gjitha në Tiranë. Ishin lirë. Tash visha në shtëpi ia jepsha ni plakut autoritativ po edhe që ka, thojsha, "Kqyre këtë shtagë ta kom ble në Shkodër", ai e merrte. Atij tjetri i thojsha, "Në Vlonë", se atëherë tana i thojshim Vlonë atëherë, a din, gega. Atij tjetrit, "Në Gjirokastrë", e kështu me radhë. Tash, kur shkonte ky dikund për dhimbje, për shembull, për ngushëllime, "Ej kqyre, shtagën ma runi mirë, aty lemna mirë", edhe tash si e kryke ky, "Zoti ju lashtë shëndosh", apo, "Përhajër qoftë". Shtaga bohej temë. "He, qysh?" "Ma ka pru djali i Selmanit prej Shkodrës", thoshte. Tash, "He bre, qysh ishte? Tek ishte?" Edhe ktu, ni tabakeja kështu kuti duhani ni diçka, ku ta di ni kamish edhe kështu do të thotë. Edhe kjo ka ndikuar, ka patur ndikim të madh.

Shkuarja ka qenë në mënyrë të organizuar, ngase edhe shkoshin edhe ne i ktheshim. Do të thotë edhe Kosova kthente me shoqëri kulturore-artistike, festivale të ndryshme, me të gjitha ato. Por, shkuarja ime ka qenë me grupe, por që edhe do të thotë, kanë diskutuar jo vetëm unë po kanë diskutuar me njerëz që kanë besuar. Kanë shku kanë bërë, se atëherë bëhej kërkesa në ambasadë t'ipej viza kolektive. Vizë, me i thanë vizë, po a din, ta jepke atë miratimin. Normalisht, kur ish ndonjëri që e disha që osht' i infiltrum, "Ky s'bon". Ku e njihsha, s'e njihsha. Kështu kanë shkue, kështu ka qenë.

**Anita Susuri:** Sa kanë zgjatë, për shembull, qajo leja për me e marrë me ju... ose çfarë kontrolli ka qenë? A ka pasë edhe dikush që ju ka përcjellë a?

**Gani Krasniqi:** Po mund të na ketë përcjellë se tashti ndëgjo, mund të na ketë përcjellë po ne kemi shkuar si grup. Turizmi është bërë i organizuar. Shteti shqiptar na ka trajtuar neve si qytetarë apo shtetas të Shqipërisë, në çmim. Për shembull, nëse turistët e huj, 15 ditë u kushtonte tre mijë, katër mijë, çka jonë kanë atëherë dollar ose euro, domethonë. Te ne ka qenë sa i ka kushtuar qytetit shqiptar edhe kemi qenë krejt hotelet luksoze. Kemi pasë autobusin e turizmit, do të thotë, që na kanë shoqëruar, cicëronët edhe kemi shëtitë cep më cep. Tash a kanë përcjellë? Ka përcjellë me siguri Jugosllavia. Mu si kanë ardhë më kanë marrë në pyetje. “Po. E kom shfrytëzu të drejtën time me kushtetutë. Kom pasaportën, ma kanë dhanë, kom shku”. Si përfundim, kur jom kthy herën e tretë ma kanë marrë pasaportën për këtë. Më kanë përcjellë ata edhe... unë e kom pasë paditë në gjyq shtetin atëherë përmes avokatit. Po edhe ma kanë marrë se e kom shfrytëzu të drejtën time, po kështu ka qenë.

‘78-ta, njëqind vjetori i Lidhjes së Prizrenit, para njëqind vjetorit të Lidhjes së Prizrenit, ‘72-ta, ajo që i ka dhënë edhe ni vulë, Kongresi i Unisimit të Gjuhës Shqipe. Aty ishte e përbashkët, do të thotë, ishte diçka që vërtetë. Ani, toskë, gegë ky dialekt, ai dialekt po je ni komb ke një gjuhë. ‘78-shja e ka shkund tani, se ishte Njëqind Vjetori i Lidhjes së Prizrenit, kishte kumtesa, i paraprinte aty tani me misione të ndryshme. Ishte sikurse që ishte, ju kujtohet kjo, njëqind vjetori i shpalljes së pavarësisë, ashtu ka qenë edhe ‘78-ta. Ishte ni lloj liberalizmi, kështu ishte. Jo rastësisht universiteti... etja tregonte, ni tkurrje e sene u hap etja. Ne kishim mbi 40 mijë student. Pse? Secili dojke me shku, s’e bojke, në studime e sene. Kto janë ato të cilat vinin edhe e bën atë që ishte.

**Anita Susuri:** Ju kur keni udhëtuar në Shqipëri personalisht, qysh e keni përjetuar? Edhe a jeni, ndoshta a jeni zhgënjyer a keni...

**Gani Krasniqi:** Jo, ndëgjo, unë e di te shumë njerëz, te shumë njerëz, sidomos të brezit ma të ri, shumë njerëz që nuk e kanë dashtë shumë njerëz e marrin... kur flas, unë flas me nostalgji. Unë jom njeri, unë kom ndjenja, unë e du kombin tim. Vetëm unë ndryshoj nga të tjerët, jo në dom të tjetrit. Por ndëgjo, nëse shikojmë realisht, Shqipëria mu nuk më ka zhgënjyer kur kam shku. Unë kom hy niherë në ‘74-tën ilegalisht kom hyrë, në ‘74-tën te Restelica. Ti duhet ta dish ku osht’ Restelica atje. Unë po rrëfhem kështu.

Ngase televizionin e përcjellim shumë, ishte etja, ishte përgatitja, kemi lexuar ne literaturë. Unë në tri vizitat që kam qenë, unë kam çu literaturë në “Rilindje” ktu. Kisha njerëzit, literaturë të cilat duhet edhe dilte dikush me marrë. E çoja në emër të “Rilindjes” edhe nuk kontrollohej. Po si kemi çuar andena përmes... por nëse e njohim Shqipërinë e pas luftës, anti-fashiste ose luftës çlirimtare të asaj pjese, nacional çlirimtare të asaj pjese, ku ka qenë, duhet të jemi të ndërgjegjshëm. Ti lajmë anash kto ideologji, kjo, ajo, ajo, ajo. Do të thotë, ka qenë mbi 90 përqind analfabetë Shqipëria. S’ka patur bukë, kanë mbytur mushkaja.

Tash, atij brezi i ka ra shumë të investojë, por kur kemi shku në Shqipëri, ti, dëgjo, çka do të thotë ti ta kesh shëndetësisjen të mos mendosh për ta, ta kesh arsimin. Lufta në klasa ka qenë, ka qenë. Sot, sot, sot vllëzërit vrahen në mënyra të ndryshme edhe jemi në pluralizëm, e vrasim njëri-tjetrin, e lëre më atëherë. Do të thotë, ka kqyrë si bashkëpunëtor të fashizmit. S'po thuhet mirë por t'i referohem realitetit që ka qenë. Plus i rrethuar nga armiqtë. Unë po thom kom hy gjithandej, veç kur hyshe ti, për shembull, në Korçë me ni fabrikë për prodhimin e mjeteve precize, në mjekësi përdorën ku ta di unë, çka po di, kur i shishe mbi 90 përqind, mbi 90 përqind ishin femra. Kur shkojshe në tekstil, Berati, aty i ke patur ni lagje bre, ni lagje e ke patur të madhe, e ke patur, ni qytet të tërin që e shishe do të thotë.

Jemi shumë të ndërgjegjshëm s'shkojke syni se asaj brezi osht' i ka takuar për të investuar shumë për çlirim dhe për ndërtim. Qysh dush ta shtrëngosh. Shteti ka qenë i ndërtuar, natyrisht, ekonomitë familjare nuk kanë qenë ashtu. Po mos harro bre, kur kemi shkuar, po tregoj, kom rrjedhë nga familjet ma të pasura të asaj kohe, me pocërrk jom la. S'po di tash, a po di ta thom. Kisha njeri te Lipjani që osht' shumë njeri i mirë, kur po shkojmë te Librazhdi dikund po e sheh t'u korrë me drapër. I shishe t'u korrë me drapër. Se ai në Lipjan edhe janë konë serbët edhe u konë rrafsh, kishin ardhë kumbajat ma herët. Nuk ishin... s'po di a po di ta them. Por, unë po thom që në raport me atë qysh do të dëshiroje është tjetër sen. Por, unë ashtu qysh e kom ëndrru e kom gjetë.

Unë tashti, të rrej nëse të thom e ke pasë këtë, e atë, e atë, jo, jo. Po ke patur ni uniformim, se në fund të fundit ka qenë orientimi, a din, orientimi socialist. Socializmi nënkupton ni barazi të shtrëngushëm por të afërt të gjithëve. Kështu uniformimin, si në ushtri. Kështu ka qenë, s'e ka mshefë. Punësimin e ke pasë, ke deshtë me punu. Natyrisht që qëllimi ka qenë për ta bërë shtetin, për ta zhdukë analfabetizmin, për ta bërë, aty ku ka mbytë malarja Myzeqenë, për ta bërë hambarë. Jo të Shqipërisë po ku ta di unë. Kjo ka qenë.

Arsimimi do të thotë ka qenë në nivel. Arsimimi i kushton ekonomisë së shtetit. Shëndetësia i kushton, se osht' parazite. Arsimimi ta kthen, po duhet për shembull për me ta kthy kur futet në prodhim atje. Shëndetësia osht' veç... ushtria, ka qenë e rrethuar. Osht' bo atëherë udhtë speciale, ju e dini qysh osht' bo çdo herë. Rendi. Të gjitha këto janë jo prodhuese, por megjithatë, megjithatë punësimi ka qenë. Nuk kanë qenë ato pagat qysh i kemi ëndërru, qysh i ëndërrojmë tash, por e ke pasur jetën, ke patur gjithë ata edhe grahi përpara. Kjo ka qenë.

Por, realiteti ynë edhe atëherë nuk ka qenë i knaqshëm. Të jemi... jo që nuk ka qenë te ni pjesë, të cilët kanë qenë të lidhur me pushtetin, kështu ka qenë. E ka patur ma mirë. Por tani gurbeti është ajo që na ka përforcuar, na ka dhanë tani ma anena. Që osht' plaga ose pjesa, plaga ma e madhe e shoqërisë edhe kombit në përgjithësi. Por megjithatë tani jemi treguar shumë vital, ngase s'jemi shkaputë kurrë nga atdheu dhe kemi jetu, kemi ndihmu familjen, kemi ndihmuar edhe familjen e madhe. Kemi ndihmu luftën, kemi ndihmu arsimin atëherë vitet e '90-ta e kështu me radhë.

**Anita Susuri:** Po du me ju pytë, ky aktivizimi ju, me thanë ilegal, i msheftë kur ka fillu ma sakt?

**Gani Krasniqi:** Ka filluar, për të kenë kështu krejt i sakt, me ardhjen, me ardhjen do të thotë në bankat e universitetit. Aty ka filluar, aty ka filluar tani edhe ma vullshëm depërtimi, literatura. Në plan të parë literatura, literaturës që ka ushqy, ka frymëzuar nacionalistë. Po e marrë për shembull, figura si monografite e ndryshme Ismail Qemali, Isa Boletini e Shote e Azem Galica kështu me radhë. Po edhe duke shkuar e duke marrë edhe karakterin ideologjik. Dihet se atëherë ka qenë formacione politike, grupe të vogla të mshefta që janë përcjellë prej NDSH-së, NDSH-së domethonë mas luftës. Tani kanë fillu edhe të majtën, ngase shteti ynë ka qenë atje i majt ka qenë. Ke patur nevojë për mbështetje, kanë qenë do të thotë... meniherë bre mas luftës ka filluar.

Prej bacës [Adem Demaçi] edhe para bacës e [Metush Krasniqit](#) e knena, tani ka dalë grupi i Gjakovës, i Pejës ku janë dënu në '68-ën, '64-tën që kanë qenë të Prizrenit. Të gjitha këto. Të Normales këto edhe... Po tani kanë filuar duke marrë edhe karakterin ideologjik, duke qenë të majt. Për shembull, grupi Marksist-leninist, jo grupi kështu. Por, të gjitha kanë pasur si platformë çlirimin. Deri kur lëvizja osht' unisuar në '82-tën për ata edhe u vra Jusuf dhe Barosh Gërvalla dhe Kadri Zeka, se e shihnin rrezikun e saj. Por, nuk ka qenë ajo pengesë pse unë kom mendu pak djathas, ti pak majtas e sene për ta ndjekur, për të punuar kundër Serbijes.

Do të thotë, ardhja në bankat e studentëve, komunikimi me njerëz e të gjithë hapësirës shqiptare të pushtuar, këmbimi, mundësia ma shumë për të këmbyer literaturë ilegale. Të gjitha këto kanë bë, do të thotë, për të filluar edhe ka lind nevoja tani për të bërë ni punë të organizuar. Vet nëse ta kom dhonë ty ni libër me lexuar, ti ja ke dhonë shokut ose shoqes tjetër. Tash osht' kriju besimi, tash kom bisedu diçka dhe janë bo ato grupet e vogla dhe kështu kanë parë... kështu ka fillu domethonë me ardhjen në bankat.

**Anita Susuri:** Po rekrutimi i ju, për shembull, si ka fillu? Dikush fillimisht sigurisht ju ka vëzhgu niherë ose osht' interesu për juve...

**Gani Krasniqi:** Po, po. Po me siguri, me siguri po ka qenë lehtë. Unë a do por të jem krejt i sinqertë kështu (buzëqeshë) edhe kështu më njohin, kush më njeh. Unë diqysh kurrë s'jom, i partisë, i lëvizjes. Disi edhe lëvizjet, do të thotë, u kom ikë, as vet s'di ta shpegoj. A din, janë konë do betime do, unë ato kurrë ato s'i kom respektuar. Edhe natyrisht në plan të parë, sikur në luftë bre, në plan të parë ka shkuar. Ti me njerin që ki komunikim, ki me njerëz të familjes. Po njerëzit e familjes, jo në kuptimin e familjes të ngushtë po dajën, tezën, shokun sene kta. Aty ti ndërton besimin. Tash duke ndërtuar... ti aty nisë, e bon, se je ma i sigurt. Por gjithsesi tani ajo vjen duke u shtrirë.

Po është puna që, është puna me të... gjithë njerëzit në të gjitha grupacionet që kanë qenë, qe për shembull Jusuf Gërvalla ka qenë në grup tjetër anena. Unë kom komunikuar me të edhe kom qenë si me qenë pjesë e tina. [Hydajet Hyseni](#) ka qenë në grup tjetër, Hydajeti, Kadri Zeka e kta. Po unë kom komunikuar me ta se kom pasë lidhje, shoktë e mi. Unë me Hydajetin për herë të parë jom pa, nashta

jom pa niqind herë po s'e kom njoftë. Për herë të parë jom pa në burg me të. Po jom pa me... për shembull, Jakupi ka qenë i organizuar drejtëpërdrejtë, Jakup Krasniqi. Na kemi qenë me Jakupin të pandashëm. Ibrahim Kelmendi ka pasë Frontin e Kuq. Unë edhe me njerëz të tij kom qenë. S'po di si të thom. Te unë nuk ka qenë kjo... edhe kështu më kanë njoftë.

Sikurse që osht' edhe në jetën legale. Në jetën legale, unë bie fjala kom qenë pjesë e Lidhjes Demokratike pa asni kompleks. Ibrahim Rugova në mledhje të parë të ka tregu, "Unë i besoj këtij opsioni paqësor". Unë e kom mbështetë. Por që e kom mbështetë... s'po di... edhe haptazi. Pse? Unë kom marrë semetën ma të ndishme. Unë kom marrë, bie fjala, Këshillin e financimit. Kur kom qenë kryetar i Këshillit financimit atje, kom qenë pjesë e anëtar i Këshillit financimit këtu. Edhe unë çdo herë kom mendu edhe kom bo shtritje.

Tjetra në '91-tën kur osht' bërë strukturimi në emër të qeverisë Bukoshi, unë kom marrë përsipër organizimin. E kom pytë, "Kush e bon? Qeveria a paria?" "Jo qeveria". "Mirë". "Pse? Pse në, ky konspiracion kaq i thellë?" "Po Serbia osht'..." "A bon me ditë ça osht' konspiracioni me ma tregu?" Ia nisi me më filozofu ai që ish, Anton Kola po i thom me emër, ishte nënkryetar. "Dëgjo shoqi jem, mos u lodh, unë po të tregoj kështu qysh unë e kuptoj. Unë e kuptoj çka që po mirrem vesh unë e ti, dola unë t'qita unë ti ma kokërron plumb. Por përbesë e qite ti unë ka me ta kakrru plumb".

Unë kom ndërtu strukturat, s'kom dhonë asniherë emër. Unë e kom pasë krejt skemën e organizmit. Ma kallxojshin kta, a din, për me i dhanë... jo, jo. Unë e kom dhanë emrin tim, kërkohet unë e kom. Ka ardhë, bie fjala, a din, po du të tregoj, po unë Lidhjen e kom majtë me shoktë e mi. Absolutisht. Ka ardhë koha, për shembull, a din se tash je bo ti, "Une themeluesi, une ai ose ai..." themelues s'ka, ka themeluesit, njëri ndër ta jom unë. Njëri ndër ta jam unë, do të thotë. Por, unë nuk jam për të thënë se kom qenë, s'po di se çdo gjë që kemi bërë ne kemi patur, ky ka qenë detyrim i ynë. Por, është puna që mu s'më ka prish punë.

Një herë me të ndjerin, Ibrahim Rugova, kom shkuar tri-katër ditë para "1 Tetorit" se edhe pas, për "1 Tetorin" kur ka qenë '97 ne kemi qenë pas. Me profesorin, të ndjerin, jemi bo miq, shokë. Kta janë konë djem të ri, Albin [Kurti] e sene, po ne kemi qenë pas tyre. Edhe ju kom lutë, "I nderuar, kështu, kështu, kështu..." S'paku isha i interesuar mos me dalë Lidhja Demokratike kundër, kundër protestës. Ish çështja e tinaj edhe Serbia, Serbia s'ki çka me i bo. Po po du të them unë e kom çmu Rugovën për arsyen se ai të ka tregu. Tjetër u konë a ia ka dhanë dikush opsionin paqësor, ajo osht' diçka tjetër. Po ai të ka tregu, "Unë e kom prek në politikë, kurdo hajde".

Ibrahim Rugovës jo që i kom tregu, po e ka ditë se në qaf e kom tjetërkond. Po mu nuk më ka penguar, përkundrazi më ka ndihmu se unë kom qenë i bindur edhe sot jom i bindur. Jo atëherë për atëherë por sot jom i bindur, Kosovës i është dashtë për t'i kryer do punë si puna e pajtimit të gjaqeve, si puna e referendumit, si puna... për të ditë bota se ku je. S'po di. Por jo edhe në pa kufi, a din. Se liria s'ka



ardhë me lule ktu (buzëqeshë). Na paqe kurrë s'kishim as sot. Në këtë kuptim, në këtë kuptim po du të them, kështu unë kom qenë.

Edhe sot, edhe sot në luftë, te unë s'ka qenë pengesë, s'po di qysh me, s'ka qenë pengesë ti pse mendon ndryshe. "A mendon kundër Serbijes?" "Po". "Ec!" Unë kom... për ata, unë kom shku kom komunik me Bujar Bukoshin. Kom shku kom komunikuar dhe ju kom treguar. Se Hashimi, Kadria kur kanë ardhë nga jashtë ditët e para kanë ardhë te une, te Jakupi, te Shaban Shala. Ne kemi qenë. Na ka njoftë edhe opinionin publik ktu edhe Serbia kush jem. Unë kurrë s'kom dalë me nofkë, unë kom qenë Gani Krasniqi çdo herë. S'po di, a po di të them.

Kështu që, unë sot, jo sot, po me lindjen bashkë me lindjen e Vetëvendosjes unë jom Vetëvendosje. Se unë nënën e Albinut dhe babën e Albinut i kam miq, i kam të hershëm, do të thotë e njoh rritjen e Albinut. Jo për Albinin, s'po di tash qysh me thënë... dëgjo, Liburnit, nënën i kom miq, nënën, nejse, babën e kom pasë edhe nënën se e ka... a ka qenë Baca Ali, Ali Aliu, Ali Presheva, ka qenë, ai ka qenë, do të thotë, çdo herë përpjekjet. Ka qenë edhe militant, partizan ka qenë atëherë kur ka qenë do të thotë se... Glaukut, babën e tij e kem pasë bashkëvuajtës, s'po di tash... po për të ardhë këtu, jom për projektin. Unë kom qenë kryetar me mandat të PDK-së, me mandat të PDK-së kur unë e kom mbështetë haptazi. Jo për inati të kësaj apo të atinaj, por për projektin, por nuk jam i Vetëvendosjes, s'po di qysh me thënë. Kështu kom qenë.

Do të thotë, unë kom qenë anëtar i shtabit të përgjithshëm. Po e thom, pa... a din, me mburrje. I kom bo do sene, kom bo tërheqje, ajo është çështje tjetër. Kom bo me konë pjesë e qeverisë së përkohshme. "Faleminderit, jo". Më kanë emëru kryetar i komunës, pa kenë komunë Malisheva. Ni pjesë ka patur, ka thanë që kanë qenë dashamir, kanë thanë, "Nëse e bon e bon ky". Ni pjesë tjetër, kanë thanë, "Hajt le të digjet qitu se s'o komunë, t'ia bojmë qefin". Kështu ka qenë. Po, po e bom komunë, e bom komunë edhe e pranunë ndërkombëtarët. Thanë, "Na imponunë komunën". Se nashta ish bo me kto komunat politike, po na e bom komunë. Kështu me radhë.

Unë nuk jom konë në Parti Demokratike kur jom zgjedhë kryetar i komunës. U bo qeveria e përbashkët, ma ofrunë, më thirrën kta shokët, Hashimi, Jakupi, qita krejt, Azem Sylja. Me Azemin jemi gjeneratë. Azemin, Jakupin e këta. "Faleminderit, jo se kom reverzë, po s'kom qefë me i pasë", se i kisha unë do sene, "që doni", thashë, "Malishevën. Kom qef me pasë përgjegjësitë e ndara", "Jo", "Doni, mirë". Erdhën se s'kishin, s'un e fitojshin. Se unë kom qenë në zgjedhjet e para, kom qenë i pavarur kandidat kështu. Fitun zgjedhjet. Thashë, "Po, me hy, zgjedhjet i keni të sigurta një", se e disha, "e dyta, fiton Malisheva por fiton edhe partia juaj. Programi ka me ua përfillë". I fitim zgjedhjet.

Prej njëmbëdhjetë drejtorive, pesë i kom pasë nga PDK-ja, do të thotë, kto i kom bo unë. Jo për hatër apo për inati. Njo e kom pasë të pavarur, një të AAK-së, sa po mbeten atje? Katër i kom pasë të LDK-së, se kom zgjedhë ekspertët që ka patur aty. Shkova aq gjatë për të treguar se më pyete [i drejtohet

intervistuesës]... unë këto formale kurrë nuk i kom përfillë as sot e sene. Unë në parti edhe tash naj herë kur shkoj, shkoj veç kqyri. Partia osht' mjet për ta punuar arën që e ki ideal ti, për aso...

Natyrisht, do të dëshiroja natyrshëm, unë do të dëshiroja diçka që s'e kom pasë bindjen kurrë as s'e kom që të fitohet pa luftë. Por, s'kishte fituar. Unë do t'dëshiroja me kta njerëz që kanë, që me kta njerëz që identifikohen që janë pjesë e lirisë, se lirinë nuk e sjellim veç ne, ne jem të bijtë e qitij populli e populli sakrifikoi. Ne ishim ajo UÇK-ja natyrisht, ne ishim në ballë, por për besë nashta edhe komuniteti ndërkombëtar na mbështeti. Por te na s'ka patur mrapa, të jemi shumë të qartë, por çmimi do t'ishte shumë ma i madh. Kostoja do t'ishte... por edhe koha do t'ishte. Ku ta di unë ku kishim përfund. Po falë tani edhe ndërkombëtarëve që i kishin edhe të mirat që na ndihmun po i kishin edhe interesin e tyre edhe hilet e tyre.

## Pjesa e Tretë

**Anita Susuri:** Zoti Gani, ju thatë që me 26 mars të vitit '81 jeni burgosë, në zyre te ju kanë ardhë. Po qysh ka ndodhë krejt kjo? Çka kujtoni prej kësaj?

**Gani Krasniqi:** E thashë edhe më parë, po du të kthehem, do të thotë unë edhe pse kom qenë tri vjet i shkëputur nga bankat universitetit, kom qenë në punë, aktiviteti ynë ka qenë atëherë në kulmin e asaj. Do të thotë, me shokët dhe shoqe kemi qenë vazhdimisht në lidhje. Me kond tash varësisht me dikond ma pak, me dikond ma shumë aq sa ka qenë. Njëmbëdhjetëshi [mars] ka qenë do të thotë i provuar, gjithsesi prapaskena ka qenë po nga studentët, ka qenë protestë e studentëve. Me 11 marsin unë kom qenë në pjesën e... në pjesën e profesorëve dhe isha ngase ky ishte roli im i vetëcaktuar, jo se e kisha të caktuar. Për të parë, ngase unë njihesha me profesorët, me të gjithë. Ky ka qenë edhe detyrë e jonja për t'u njohur, për të parë, ku, çka, qysh, tek. Për ta njoftë mënyrën ma pak, mënyrën më shumë mirë po najnjo që ka patur edhe të pa mirë, të mos thom të keq.

Në mesin e tyre unë kisha edhe njeriun tjetër që ishte koleg i imi që ka diplomu në afat rekord dhe kurrë s'e kam pa t'u hi në provime, ka dekë gjyna osht'. Por unë i kom rujtë ato raporte edhe i kom hy edhe në shtëpi, Fatos Hamza, djali i Xhevdet Hamzës. Po edhe jo vetëm Xhevdet Hamzës, po unë kom hy edhe në familje, kom gjetë djalin, vajzën, nipin, dajën për të hy se kështu ka qenë ai atëherë për t'i hy brenda. Unë rrisha me të, kështu që unë veç vëzhgojsha. Kur kemi shkuar, ka fillu kolona ktu në rrugën kah Grandi, te semaforat kryesor është kthyer atje. Kur kanë shkuar te semaforat para menzës [së studentëve], s'di a kanë qenë semaforat, më doket s'kanë qenë atëherë, nuk e di, s'po më kujtohet. Janë grumbulluar. Unë isha me pjesën e këtyre.

Aty kish njerëz edhe të politikës, të Lidhjes Komuniste, profesorëve. Një ndër ata bënë plan për t'i çuar në "1 Tetor", [atëherë] "25 maj" dhe për t'i dëgjuar. Natyrisht për të ardhë dikush nga Komiteti për t'i dëgju kërkesat e tyre sociale. Unë marrë informacion, tash kisha lidhjen edhe kisha ku me çu me

thanë, “Gaboni, mos hyni atje në ‘1 Tetor’. Aty naluni”, edhe janë ndalë. Ka marrë fjalën Aliu, ka majtë fjalën [Pajazit Nushi](#), ka qenë kryetar më duket i qeverisë a i kuvendit nuk e di, Pajazit Nushi. Aty osht’ shpërnda. Tani në ato ditë kanë qenë ditë të punës intezeve për t’mos ta lanë për të heshtë dhe për ta kapë për ta kthyer, jo karakterin social. I përplasën pjatat e sene, qita Bajram Kosuma, krejt kta, kto kanë qenë të vërteta. Por, për t’i dhanë karakter politik.

Do të thotë, lëvizja është aktivizuar, unë kom qenë në lëvizje, kom ardhë në punë në mëngjes me 26 [mars]. Puna e parë e kom marrë ni fiqë<sup>1</sup> të shokut aty për të shikuar, a din, si po shkon puna, jom sillë rreth konviktit. Pak edhe na të ri, e din ti. Se mu m’ka ndodhë dy-tri herë m’kanë çuar, se po duhet m’u kthy, dy-tri herë m’kanë çuar në shtëpi, se atëherë ka qenë ni kohë me vetura, tek që mbaron me tek edhe e parë, për shkak të mungesës së benzinës që ish çmimi shtrejt shka po di une. Sot me kto me tek ni ditë ato me pare, e kështu. Ni kushtu që visha unë në punë me të, ai e kish, për shembull, tash e kish ni ditë vijke, ni ditë s’vijke u dashke me shku me autobus.

Këta ishin konë t’u më përcjellë. Kur jom dalë, ku osht’ ai Ibër Lepenci, jo, po, Ibër Lepenci, aty t’u shku në stacion të autobusave aty dikund. Bile stacioni ka qenë atëherë ktu më duket, po qaty dikund më kanë nalë, në veturë më kanë nalë. Targat e Gjakovës i ka pasë, “Për Gjakovë?” Thashë, “Mirë je”. “Ku je t’u shku?” Thashë, “Te autobusat”. “Po, hajde”. Hyna në veturë të tina. Këta janë konë punëtorë të Sigurimit, masanej e kom marrë [vesh], s’e kom ditë. Po atë ditë s’e kom ditë, po masanej tani e kom marrë vesh. Kjo kish qenë pas 11-shit [mars] a din, se kta ishin t’u më përcjellë. Tash t’u shku m’tha, “Nga je ti?” Thashë, “Po i Carrallukës të Malishevës”, “Po”, tha, “unë jom t’u shku në Gjakovë a po vjen?” “Po more, po vi”. Më lëshon këngë të Radio Tiranës.

Po unë edhe isha i lodhshëm diçka, se a din, jo që mendojsha provokim po të bohem shumë i sinqertë, po diqysh s’di as vet ta shpjegoj. Nuk i binte... m’ka çuar deri, e ka thy rrugën e zgjatur, s’ka qenë asfalt, e ka thy rrugën po më duket edhe s’ka pasë rrugë, jo, po paska qenë kjo për Pejë. U ardhë deri në Malishevë, Carrallukë s’hyke vetura. Më tha, “Po më vjen keq, s’muj të çoj”. “Jo bre”. Tani kur u përsërit kjo këto ditë tani e kom hetuar që janë... mos me çu gjatë. Edhe tash më kanë përcjellë edhe kanë ardhë dy në uniformë, katër civilë në “Avalle”, ku osht’, p’e dini? P’e dini ku është “Avalija”?

**Anita Susuri:** Po.

**Gani Krasniqi:** Kati i parë aty kemi qenë, zyrja numër gjashtë kur fillon nga atje me ardhë knena janë rrasë brenda. Kam patur katër praktikant, kishin ardhur s’i pranojke kërkush. “Hajde”, ju thashë, “hyni bacit ktu”, (qeshë). Njani kishte qenë i Lëvizjes, nuk e kom ditë masanej ai e ka majtë mend. Djali i Rifat Kukës, si Migjen e kom majtë mend, a din. Mos me çu gjatë janë ardhë më kanë arrestuar në emër të popullit. Më kanë majtë... domethonë ka qenë dikund rreth orës 10:00. Atë ditë ishte stafeta, kalonte

<sup>1</sup> Zastava 750 ishte një makinë supermini bërë nga prodhuesi serb i makinave Zavod Crvena Zastava në Kragujevc. Në botën shqipfolëse, Zastava 750 njihet gjerësisht me nofkën “Fiqa”, që vjen nga personazhi kryesor i një komiku të botuar nga gazeta “Borba” gjatë viteve të para të prodhimit të makinës.

nëpër Prishtinë. Ne kishim detyrë, secili tash aty, që me dështuar, me përzi hesapi. Po mu më arrestuan. Mu më kanë konsideru koka. Unë s'kom qenë koka, se kështu edhe në burg m'u kanë drejtuar, m'kanë majtë ma së shumti, s'di pse sinqerisht. Po kom pasë lidhje edhe me shtetin shqiptar e kanë bo. Po, sidoqoftë, sidoqoftë, më futën në burg, jo në burg. Niherë më çunë në Sekretariat, m'i lanë dy vetë aty. Ka qenë ni Hamit, shofer thojke jom, llapjon kishte qenë. Njeri i mirë kishte qenë. Bile në kohë të bukës rrike jashtë, se atëherë ishte përzimje e madhe. Pijsha duhanin, m'ka dhanë cigare ai. S'më lanë me marrë asgjë. Edhe kur janë kthyer, janë qetësu pak janë ardhë m'kanë marrë. Nga aty kanë filluar ato, m'kanë çu, une 52 ditë...

**Anita Susuri:** Ishit t'u na tregu për, për arrestimin. Ju kanë sjellë...

**Gani Krasniqi:** Po, po. 52 ditë, se atëherë burgu ka patur, atë ditë që kem, 1-shi ka qenë qelia. E vetmja qeli e ka pasur, 1-shi. Nejse tash doket, tash doket modern. Ata e kom zanë unë, 52 ditë kom qenë [aty]. Unë nuk e kom ditë çka po bëhet edhe te 1-ishi nuk i ka pasë ato banjo e sene. Asnjo nuk i ka pasë ato banjo. Janë konë do farë çypa që ju thojshin, kiblla çka u thojshin. Niherë qitke në mëngjes, kur të qitke kishe me shëtitë edhe m'i la sytë edhe ke pasë, se ata... ka patur ni llamarinë me vrima, nuk dishe çka o ka bohet. Atëherë ishin, kuptohet, ishin malltretimet shtazarake. Po kur ki motiv, njeri i ri, sa ma shumë të malltretojshin e dijshe që atje po zihet. E dijsim.

52, pas 52 ditësh më kanë ngritur lartë me ni dhomë, s'ka pasur shtretër. Se tash i kishin bërë t'mdheja për shkak vonë kanë qenë dhomat ma të vogla, si thasë të qymetit. Aty Milaim Zeka, ky Milaim Zeka më ka borxh. I ri ka qenë, gjimnazist, djalë shumë i kfejlltë. Ky më ka njoftë mu, unë nuk e kom njoftë atë. Ky ka qenë i organizuar me grupin e Drenicës atje. Jakupin profesor, Azem Sylën e këta. Ky m'ka pa mu me kta, po kur jom hy tash u pak. Çohet më përçafë, "Ku je Gani, Baci Gan", anej-knej. Po për tregu mos ta çu gjatë, se në burg as s'jemi të partë, as s'kemi qenë.

Po për të tregu ku ka qenë ai 50 e sa ditëshi, kisha një vizitë. Po më thotë njëri punëtor i [ndërmarrjes] Ramiz Sadikut, Zeneli, Zeneli, Zeneli e ka patur, ktu i Orllloviqit, Nysret Zeneli. Thashë, "Po ta marrë qit' setër", më tha, "T'bjen e madhe", po m'thotë ai mu, a din, për me dalë në vizitë. "Po more, merre po të bjen e madhe". Tash unë e shikojsha atë, unë nuk e shisha vetën qysh jam. Unë e disha qysh jam. Thashë, a osht' në terezi ky. "Hajt bre", thashë. Kur e kom veshë m'rrijke setra kështu {shpjegon me duar gjerësinë}, p'e din. Atëherë e kom pasë. Tash kjo osht' ajo që ju tregon cilat kanë qenë, jo për mu po për secilin malltretimet.

**Anita Susuri:** Keni ra në peshë shumë?

**Gani Krasniqi:** Po, po, po. Ndëgjo bre, setra më rrijke kështu {shpjegon me duar sa e gjërë i ka rënë} sikur, sikur ta shtish në krane. Mos me çuar gjatë kom qenë i ngarkuar, pos asaj për organizim, përmbysjen e shtetit kom patur edhe ni nen, ka qenë për bashkëpunim me shtetin e huj, Shqipninë demek.

**Anita Susuri:** A i kanë shfrytëzu edhe vizitat si lloj preteksti?

**Gani Krasniqi:** [nuk dëgjon].

**Anita Susuri:** Vizitat që i keni pasë në Shqipëri, a i kanë shfrytëzu si lloj preteksti?

**Gani Krasniqi:** Po vizita ka patur përditë. Po e mora vesh tani që edhe më kishin pasë në zyre m'kishin pasë inxhizu. Unë nuk flitsha në zyre se unë e disha se kom pasë telefonin në zyre, po vijsha në postë me ta. Ni insert e kom gjetë që e kom marrë vesh. Ishte Titoja para vdekjes, ishte në ato, në ato spitalet sllovene edhe ishte koha diqysh si e ftohtë ka qenë, nuk e di. Unë bisedoj me të them, "Si po mban koha atje? Mban acar?" "Jo, jo", në Beograd. Thom, "Në Slloveni acar, ngrin gishti dhe këmbët", a din, se ia patën pre. Aty e kom marrë vesh që më kishin pasë inxhizu. Tani e disha edhe kur kanë ardhë me më inxhizuar, a din. E disha masanej. Po më kanë përcjellë, ato kanë qenë në përcjellje. Je shpërfaq ti. Kanë pasë atje ambasadë, kanë pasë njerëz. Po, s'osht' me rëndësi. Me rëndësi është që ktu më kanë dënuar. Kur më kanë dënuar, do të thotë, dihet. Orhan Rakathati ka qenë i Prizrenit që m'ka dënuar...

**Anita Susuri:** A ju kanë dënu si grup apo si individ?

**Gani Krasniqi:** Jo, jo, jo. Te unë nga grupi s'kanë patur veç që m'i kanë bërë, veç që kanë lidhë, unë, Jakupi, a din, që jemi konë të pandashëm. Ky me ndonjë literaturë naj sene edhe një Thaçi. Përndryshe, s'osht' zbulu grup po që kemi... tani Jakupi osht' zbulu prapë që ka dalë me Grupin Marksist-Leninst. Unë kom qenë me ta, po a din që thashë, nuk i kom dhanë randësi. Unë gjithë kam qëndruar kështu. Më dënunë 17 vjet, dhjetë për këtë, shtatë për atë, do të thotë bashkëpunim me shtetin. Po atëherë dënimi kapital ishte 15 vjet në bashkim të veprës. 15 më dënun mu, 14 Jakupin, njëmbëdhjetë Hisniun, Hisni Thaçi. Kur jom taku me Milaimin, po kthehna edhe niherë pas 52 dite. Aty tash Milaimi ishte në gjendje për t'i thënë të gjitha komentet e "Zërit të Popullit" që kishte dëgjuar thurjen e tij, aty duke... inspektorët e atëhershit. Ka qenë shumë inteligjent edhe osht'. Osht' i mrapsht po edhe osht'... i ri, sene. Mora vesh kush osht' edhe mos me çu gjatë, kjo ishte me randësi. Unë atëherë kom ditë se çka osht' duke u bërë. Tani i kishim vizitat. Na dënunë...

**Anita Susuri:** A keni qenë në Prishtinë apo ju kanë transferu?

**Gani Krasniqi:** Në Prishtinë do të thotë e grupi i parë i transferuar prap aty. Çka po di une. Mu me ni ksi, kanë qenë do farë s'di çka ju thojshin, njësi speciale [me vetura] si Land Rovera. Mu, Bajram Kosumin... mu ma s'pari. Ka qenë ditë me diell po ftohtë. Do të thotë shtatë-tetë muj me dënim e me këtë. E kanë pru Bajram Kosumin edhe Januz Jonuzin. Bajrami si m'ka pa, tha, "Baci Gan, a je ti?" Se kta m'kanë njoftë mu, sikur tash, krejt të ritë më njohin. Po masi e lam tash, a din, nga përshkrimi i shokëve. "Po". Edhe na kanë çu në Beograd.

Kur jemi shku në Beograd, natën nuk e dishim ku jemi. Na kqyrshin si majmuna. Na futën me ni, secilin nga ni dhomë. Tri ditë na mbajtën në dhoma të spitalit të Beogradit, po nuk e dishim ne. Po na qitshin me shëtitë në mëngjes, s'dishim. Po ata nuk folshin, i pytshim, "Ku jem?" Ditën e tretë e kom parë në këllëf të jastakut shkrunte KPT [Klinika plućne bolesti i tuberkuloze srb.: Klinika per sëmundje të mushkërive dhe tuberkuloz] Bolnica Beograd edhe tani ju tregova. Ju thashë, "Jemi ktu..." tani na qitën. Aty do të thotë prapë kemi qenë aty diku shtatë-tetë muj edhe aty. Secili kemi qenë veç e veç në dhoma. Dhomë...

**Anita Susuri:** A spital, a si burg?

**Gani Krasniqi:** Ja, ja spitali ishte për burgun. Jo, ishte, atje a din sa pavijonet ishin? Do të thotë, ishin nja 30-40 metra distancë, shtatë-tetë kat përpjetë. S'disha as me dalë. Tash shëtitjen e bëjshim mes qatye, veç qielli e shihshe. Po tani na qitën në dhoma. Dhoma, vetmi qashtu ish e ndërtume. Kishin ato, se a din, kemi lexu masanena. Ishte burgu që e ka ndërtuar Krali [Srb.: Mbreti] për komunistët, edhe m'i lidhë me ato kllapa. Për ata shtatë-tetë muj dikund nja pesë muj unë kom patur rihetime nga... aty kom vrejtë. S'du tash ta tregoj atë historijen, po du veç... është me rëndësi, e vlerësoj. Jom shumë i singertë. Aty kom bisedu sikur jom duke biseduar me ju. Inspektori atëherë ka qenë 60 vjeçar, s'mujshe me thanë që i ka 30 vjet, serb. Kemi bisedu shtruar. Unë kom mbrojtë të gjitha pikëpamjet e mia *tu, tu, tu, tu* {onomotope} të gjitha.

Kur ka ardhë puna, do të thotë, pesë ditë të javës vetëm të premtën edhe të dilen jo. Të premtën kishim radhën për t'u pastruar, të pestën, të dilën pushim. Nga tri-katër orë, pesë-gjashtë orë. Por, nuk ka patur asni, kështu... aty e kom vrejt se ai, se mu hetimet m'i ka udhëheq inspektorët e krahinës dhe inspektorët federativ për këtë pjesën shqiptare. Ka qenë ni serb edhe ni Xhevdet Shushka. Ai kish qenë inspektor federativ për këtë pjesën shqiptare. Tash e kom parë. Unë e kom ditë që Beogradi, do të thotë, Sekretariati i Serbijes nuk i beson Kosovës. Por, unë e kom pa që ata nuk i besonin as atij federal. Nga pytjet, nga të gjitha ato.

Kemi bisedu shumë shtruar. Aty e kom vrejtë, ka qenë njeri shumë i ngritur, shumë njerëzor, shumë profesionalist, shumë nacionalist, shumë komunist, fanatik, ortodoks. Por, tri herë ka qenë i provokuar prej meje, niherë e humbi toruan. Jo që asi... po ai më bijke aty unë i tregojsha realisht. "*Bio si član partije?*" [Srb.: Ke qenë anëtar i partisë?] Thashë, "Po", "A je kanë anëtar", m'fal se, "A je kanë anëtar?" Më tha, "Po", thashë, "Si e ke ndier vetën?" "Do", thashë, "sinqerisht ta them?" "Po", tha. "Unë", thashë, "kom qenë në studime", kish kërku për freskim edhe kështu ishte realisht, kishte kohë për freskim Lidhja Komuniste atje.

Thashë, "Ai kryetari që ka qenë në katun atje e ka dhanë emrin tim. Duke qenë student, unë nuk kom ditë", thashë, "më ka ardhë ni ftesë të shkoj. Më thirrën, kur shkoj nuk e di a shkoj në shkollë, je anëtar", "Kush të ka thanë?" "Ka qenë ni mësues", tha, "Po", kështu, kështu. Thashë, "E kom ndi vetën i fyer", beso isha shumë i singertë. Tha, "Si ashtu?" E pashë që u prek. Thashë, "Se", thashë, "atje ata të cilët

kanë qenë anëtarë të Lidhjes Komuniste janë konë do lahpera, do kështu njerëz të pa bam, të pa vlerësuar edhe kom thanë që edhe unë bohna si ta”. U prek po nuk u dha.

S’po di... tash ia nisi po thotë, “Kur jom konë unë u bo kështu, ka qenë me konë kandidat...” se edhe më pyti, i thashë, “Nuk e di, veç e di këtë”. U ndje i fym. Herën tjetër që ka qenë i fyer në këtë bisedë po edhe ktu nuk u dha. Pak u dha ma shumë, po jo. Duke u mbrojtë thashë, “Ne jemi”, thashë, “populli i tretë”, ndër tjera. Bisedojshim shlrë bre, miqësisht bisedojshim. Tash u kriju ajo, ishte i ngritur. Thashë, “Ne jemi popull i tretë. Ni Mal i Zi”, thashë, “nuk i ka 70-80 mijë”, a i kish njiqind mijë atëherë banorë, po unë tash qëllimisht pak ma... tha, “Ai ka derdh gjak”, a din, mënyrën qysh e tha e pashë që... thashë, “Edhe ne kemi derdhë gjak, po që ka nevojë do të derdhim gjak prapë”. E pashë aty, do të thotë nuk i erdh mirë.

E treta ka qenë që u nxu ngusht, aty u nxu ngusht, por prapë u nxjerrë. Duke bisedu, duke bisedu te mujin e fundit ku dojshin kta, e shoh më shkon rreth asaj ofertës, po them kështu, ashtu ka qenë, për bashkëpunim. Po shumë lehtë, shumë... tash. “Megjithatë, e ki babën plak e fmitë e këtë, anej, e ndryshe është me majtë këtë”, a din, krejt shkoi, “ndryshe, 15”, tha, “po thom”, tha, “s’ki me i majtë po dhjetë të sigurtat i ki”. Hala nuk e kishim... përnime tani vet i hjekshin ata dhjetë, me rëndësi me bo kërkesë. “Ju jeni idealist e ndryshe me konë në Kosovë e ktu”. Shkoi ajo, erdh dita tjetër.

Po vjen, erdh dita tjetër, vjen çdo herë, “Qe për shembull ju jeni idealist, për shembull ktu ka lloj-lloj kriminel. Don” tha, “ktu dikush, për shembull me mytë ni njeri atje. Ty nuk ta banë, duheni me tregu me pshtu njerin”. Ke ti parasysh, vijke çdo herë. Kur erdh puna, “Jo, po tani a din, do të thotë që dhjetë ki me i majtë, 15 jo, po dhjetë po. Me kenë kështu mbahet shumë edhe mund të shkosh ta bojsh vizitën në shtëpi”, vijke çdo herë duke kështu kështu.

Kur e pashë që atje më erdh thashë, “Shoku Mishë”, tha, “Urdhëro!” “Unë”, thashë, “do të shkoj në shpi një. Unë” thashë, “dhe ne do ta fitojmë të drejtën tonë dy. Kta”, thashë, “kom bindje. Po unë”, thashë, “kur të shkoj”, thashë, “du ta them të drejtën time për ta parë secilin në sy. Kjo është liria ime”, thashë, “po m’vjen keq”, edhe sinqerisht ia thashë këtë. Ia thashë, “Unë të kom çmu edhe të çmoj shumë si njeri”, se vërtetë më krijoi këtë përshtypje njerëzore, “të kom çmu edhe të çmoj si intelektual, të kom çmuar”, thashë, “edhe si zanat, profesionalist”. Thashë, “Këtu” thashë, “të gjitha i kemi biseduar haptas”, thashë, “ti veç merri analizoj ato bisedat, qysh mendojshe ti”.

Tash u nxu, po prapë u nxirrë. “Kqyre”, tha, “shoku Gani Krasniqi. Kjo”, tha, “osht’ detyra ime. Jo”, tha, “në vitin e fundit, në mujin e fundit, jo”, tha, “në ditën po edhe në sekondin e fundit duke përcjellë, detyra ime”, tha, “osht’ me të ofru bashkëpunim”. “Ani”, thashë, “gjoje ata”. Do të thotë u nxirrë prapë. E tash kjo ka bërë prej atyhi pas shtatë-tetë muje na kanë çu në Beograd. Kjo ka bërë që në Beograd, në Nish, prej Beogradit na kanë çu në Nish. Po, se e thashë. Kjo ka bërë që deri në ‘86-tën nuk m’qitshin mu atje në izolim. Kish edhe tjerë po mu diqysh. Prej krejt dhjetë vjetve janë, 19 muj, pak pa i mbush 20 ma

shumë se 19 muj që kom nejt te të burgosurit, ku rrijnë të burgosurit në izolim. Atje pa i llogaritë ato qeli e sene, ato janë tjetër sen.

Në '86-ten, atëherë e kom marrë vesh se më treguan te ky Mishoviqi. Në Burgun e Nishit ka qenë ni inspektor, Debi, *državni*, inspektor shtetëror. Do të thotë që është marrë me të burgosurit politikë. Ai ka marrë të gjithë të burgosurit, i ka marrë, i ka pytë. Unë ata e njihsha Nishoviq, veç e njihsha si emër prej shokve tregojshin, "Kesh te Nisha, te Nisha". Mu hiç s'më merrke. Unë jo që kisha qef po... edhe tash te '86-ten burgoset ni grup. Kanë qenë dy edhe gjykatës. Njëni ka qenë i Pejës, i Vuthaj, po në Pejë i dalun, i Klinës. E ata kanë qenë, kanë marrë literaturë prej meje. Edhe thashë me siguri edhe kishim thanë, "Ju nxojnë literaturë, ju nxojnë sene. Gjuni te ne që jemi në burg, çka kanë me të bo".

Ka ardhë Ibush Kllokoqi, se Ibush Kllokoqin e kom pasë inspektor kryesor ktu. Ni Nura ka qenë, që ia harrova tash emrin, s'ia harroj e kom të shkrum, i Vushterrisë. Ka qenë Adem Goga i Ferizajit. Kanë qenë edhe tjetër, po kta kanë qenë që janë sjellë poshtërsisht. Ai Nura jo. Çka, ku kesh? Po ka ardhë Ibushi me ni Nimanin, Nimani osht' i ktyne i "Bananev" më doket, i Pejës, a din i kom shkru. Kom pytë, jom interesu, s'e kom njoftë ma përpara. Kanë ardhë edhe po më thirrin mu. E disha, vizitë s'kom, te mjeku s'kisha me shkue. Prej izolimit... kur shkoj, "Unë" tha jom, "Nishoviq". E tash unë Nishoviqin e dijsa, ia jep dorën, ia japë dorën edhe atij Nimanit që nuk e njihsha. Ibushit nuk ia jap dorën ngase e njihsha. U ndi i prekun. Thashë, "Jo kjo dorë", thashë, "më ka ra..."

Jemi ulë, Nishoviqi po më kqyrë. Më tha, "A po i njeh?" Tha. Thashë, "Po, kta po e njoh, kta jo", thashë, "Koleg i ktina", tha, "osht' Nimani". S'di qysh e pat' emrin. I kom shkru të gjitha këto. "Në rregull", tha, "Gani Krasniqi", tha, "unë s'të kom thirrë ty", tha, "te ai", tha, "ngase", tha, "Mishoviq më ka thanë, 'S'ke çka'". Tasht e mora pse mu nuk më ka thirrë ky edhe pse mu më kanë mbajtë ma shumë gjatë. Do të thotë, "Ai osht' njeri i mirë i mirë po as nuk lëvizë prej pozicionit të tinaj", qashtu ka qenë. Tash, Ganisë, Ibushi, serbisht i thotë, "Ne kemi ardhë", thotë, "po ka qenë mirë, kemi ni punë po ka qenë mirë", thotë, "masi ne jemi të tre shqiptarë, ky aso, ti e din serbishten, ne e dijmë me folë serbisht". Serbisht po thotë ai.

Unë po i thom shqip, unë po i thom, "Të drejtën time e kam të garantuar me kushtetutë, por", thashë, "thirreni përkthyesin, jo nuk flas serbisht. Me kto [Nishoviq]", thashë, "flas, po me juve", thashë, "nuk flas serbisht". "Eh", tha, "Gani Krasniqi", Ibushi, "shifet", thotë, "na keni helmuar", thotë, "jo atëherë po edhe sot helmimi ju". Thotë, "Kemi njerëzit", thotë, "të ri, doni me i helmu rininë nëpër burgje t'u ra edhe pas pesë vjete", kështu thotë Ibushi. Ia kom nisë i kom folë serbisht. Thashë, "Shoku Nishoviq", se kështu u dashke me thanë, sikur tash zotëri. Edhe pak, nuk e përdori kta zotëri po kur po je me dikond, a din, pak për mos me thanë koke katunar, a din që thojnë (qeshë).

Thashë, "Ky më tha, 'Je kështu, kështu i papërmirësueshëm, nacionalist veç sa s'më tha fashist'", thashë, "Unë", thashë, "në të vërtetë jom nacionalist. Unë", thashë, "jom nacionalist i vërtetë", thashë, "edhe unë e du popullin tim, e du lirinë e popullit tim. Unë i du të gjithë popujt, por", thashë, "nuk e du



lirinë në dom të tjerëve. E për mu”, thashë, “populli serb nuk osht’ armik, osht’ ai që më mban ktu në burg, është regjimi, ai që ma ka bërë këtë këtë. Po unë”, thashë, “jom i singertë, kta”, thashë, “nuk janë të singertë”. Serbisht ia kom thanë. “Le të bohet i singertë ky”, thashë, “le të thotë, a ma mirë do të ndihej të kishte thënë, jom *republički*, inspektor i republikës apo *pokrajinski inspektor* [Srb.: inspektor krahinor]. T’ia ka nisë me kesh ai. Aty tani më tha, u nxi, t’ia ka nisë me keshë. Tha, “Shikoje”, tha, “se vërtetë”, tha, “ka qenë, kështu më ka shpjeguar Mishoviqi për ty”, tha, “ka thanë është njeri i mirë, është i ngritur, është kështu është ashtu, idealist edhe si ai s’ka. Nuk ndrron pozicionet”. Natyrisht pas, dhjetë vjet, kemi nejtë aty. Jemi, aty...

**Anita Susuri:** Në Burgun e Nishit e keni kalu?

**Gani Krasniqi:** Në Burgun e Nishit, krejt do të thotë pjesën ma të madhe. Do të thotë ni vit e gjysmë ktu dhe në Beograd, shtatë-tetë muj. Nga shtatë-tetë muj e gjysë, tash nuk e di. Unë i kom ato të shënime i kom. Aty tani jemi takuar edhe me shokët që i kemi njoftë njëni-tjetrin, po s’e kemi pa kurrë njëni-tjetrin. Aty tani natyrisht kemi shfrytëzuar burgun, kemi lexuar. Unë klasikët i kom lexu e do të thotë 80 përqind të klasikëve i kom lexu serbisht se s’kisha. Kisha naj literaturë po s’kish kumeditë. Jo unë po edhe shokët.

Natyrisht edhe aty nuk e kemi ndalë ne veprimtarinë, nuk i kemi ndalë lidhjet edhe me jashtë. Por edhe me brenda, ne plot kemi bindur serbët, të burgosur ordiner. Dhunues, [që kanë] vra nanën, babën, gruan, çka s’ka pasë. Tjerët te shqiptarë ke pasë, po jo në atë masë. Po duke qenë idealist, duke pasur ti me shqiptarë jo vetëm me të burgosur politikë, po edhe, tash edhe aty na ka formuar. Dëgjo, ne jemi njerëz, që thojnë, “Unë jom konë kështu”. “Jo, jo s’je konë kështu”. Kjo osht’ ashtu.

Duke parë... o s’ka bre me kombin shqiptar. Qy, ky e ka mytë babën, ky e ka mytë nanën, ky e ka mytë kta, ky e ka mytë ata. Po, po edhe aty edhe zyrtarët na kanë trajtuar... kish edhe malltretime e sene, kish... ne nuk i kemi bajtë ato, do që kanë qenë palidhje me i mbajtë dur të mrapa. Na çojnë në qeli punë e madhe. Nuk kemi lejuar. Ne kemi arritur pastaj për të organizuar protestë, grevë. Mbi 90 përqind të burosurve politikë, të burgosurve serbë që kanë qenë të burgosur në krejt burgun janë konsultu. Se ne kishim, a din, lidhje me ta në katër pavione.

Fillunë me ardhë ernat e reja, që fillunë me ardhë Sllovenia, Kroacia e kta hiç. Filloi edhe Bosnja tash ne i shfrytëzojshim. Ata janë konsultu, “Po keni të drejtë”, “A keni të drejtë?” “Po”, “A na mbështetni?” “Ju mbështetim”, “Veç ne ju mbështetim po ne nuk kërkojmë”, “Po”. Në katër pavijonet u merrshim vesh mes veti. Kur jemi shku të nesërmit... po në mramje kanë shpallë kta grevën, kur i kanë mbyllë dyrtë, ne ishim marrë vesh nga secili pavion shqiptarë, kemi, ia kemi drejtu drejtorisë letrën në zarf. “Ne të burgosurit politikë shqiptarë plotësisht solidarizohem me kërkesë të burgosurve ordinerë, por ne nuk kërkojmë falje, nuk kërkojmë”.

Po a din çka ishte për ta bre? Kur jemi dalë jashtë të nesrit me shkuar, e kishim mëngjesin me shku në punë, zi. Jo që erdh te unë, po qëlloi komandanti burgut afër meje. Ishin çmendë. “Erdh Krasniqi, a din ai Krasniqi”, veç kur kanë dalë tre vetë, serbë i kanë dalë përpara. A din, po e tregoj këtë që edhe ata na kanë trajtuar tani. Tha, “Jo, krejt çka...”, “Jo bre”, tha, “veç po du me pytë”, tha, “Ani”, tha, “pytë”. I dulën të burgosurit përpara mendun që... po jo, qëlloi afër edhe m’u drejtu, a din. Tha, “Kur nuk hahet edhe nuk punohet... natyrisht nuk punohet”, tha, “në pavijon”. Shkum krejt në pavijona.

Po du të them, kemi arritur... unë kom dëgjuar me vesht e mi zyrtarë t’u thanë, “O Hysni, ky Hysni”, për Hidajetin, “vërtetë”, thojshin, “osht’ kapacitet”. Unë e kom dëgju. Atëherë, po kështu ka qenë do të thotë. Edhe te të burgosurit e tjerë na respektojshin haptazi thojshin, “Mos me kanë kta nuk vjen era njeri”, kta janë kështu, kta janë kha. Kjo osht’ ajo pjesa e burgut kur...

**Anita Susuri:** Ju keni pasë edhe punë aty me bo apo?

**Gani Krasniqi:** Po de, po. Ama mu pak më ka ra, mu pak më ka ra. Do të thotë, mu më ka ra qata 19 muj. Më lëshun niherë, më lëshun pak, më lshun pak nja dy muj po s’di, hiç nuk e di pse. Në qatë 19 mujshin më lëshun nja dy muj. Erdhën... po me siguri ajo porosia që ka qenë. Po ktu ka qenë pak interesant për të besu, se erdhën masi u mbyllën ato, vijmë nga puna. Erdhën thanë, “Dojmë me të bastisë se dyshojmë diçka”. “Bastisni!” Kqyrën në dollap, tash kqyrsha aty mos po më lojnë naj sen po edhe dollapin që e kisha tash mujke me të shti diçka. Po unë nuk e lejojsha.

Nëse osht’ diçka që nuk osht’ e imja thojsha, “Mos e prekni”, po në dollap s’kisha pasë. Kur shkun në shtrat e kishin shti ni copë të metalt, a din, pak si të mbrehtë në shtrat. Kur e çunë dyshekun, *bërr* {onomotope} ra, thashë, “Mos e prekni. Mos e prekni!” Thashë, “Ka mundësi le të vjen”, thashë, “në gjurmë e sene, këta e ka lanë dikush”. “Jo more”. “E prekni”, thashë, “në përgjegjësinë e ju. Kjo nuk është e imja”. Prej aty kalun në dhomë të atij Muslim Dobrunës, i Gjakovës. Kur shkum aty i kishin pasë bo po pak, bile aty u përzina po ai... i kishin pasë bo a din kjo teli, armatora që osht’ tetshe a dhetshe nuk e di e ia kanë kthy kështu edhe kha ia kishin pre majën pak a din ma moderne. Njëjtë e kanë lanë, ku ta di unë.

Kur ka ra *bërr* {onomotope}, “O”, thashë, “ti i Gjakovës paske”, serbisht unë p’i thom... ky nuk e dike serbishten hiç, ky i Gjakovës (buzëqeshë) ky shoku. Thashë, “Paske avancu”, thashë, “në armatim”. Atyne ju erdh inati, tash ki parasysh. Na thanë edhe diçka edhe “Kemi urdhër me ju çu”. Na çunë. Na çunë, jo në qeli po drejt në izolim edhe atë nuk e di pse. Ku ta di çka ju ka marrë menja...

**Anita Susuri:** E kontaktet me familje...

**Gani Krasniqi:** Me familje i kemi patur kontaktet do të thotë kanë qenë vizitat mujore. E vizitat kanë qenë të... kemi pasë do të thotë veç, mbikëqyrës edhe zëri i inxhizum po edhe polici që ka folë, që ka ditë shqipen. Janë konë me origjinë nga Kosova, i kanë pasë pru edhe do që i njëfishim qita gardianët.

Kështu ka qenë. Natyrisht pritja kur na kanë çu ka qenë shumë e ashpër, shumë e poshtër, do të thotë pa asni motiv, se kur më kanë çu mu ma s'pari... edhe aty kom qenë i pari, kumeditë qysh i ka ra bre dreqi... mu, Hyzdri Gegën i ndjeri tash e ka me 22 i bon ni vit që ka vdekë, i Sallagrahdës, i Suharekës ka qenë. Të rrallë janë ata njerëz si ai, të rrallë. Edhe Muhamet Rugovën profesorin e Gjakovës. E aty na kanë, na kanë çu në izolim drejt. Por, aty s'kanë vetë. Të kanë fyer sikur... po kush e bojke llaf, punë e madhe. Ishim të ri. Deri sapo, aty osht' punua, osht' punu po osht' punu ata të cilët kanë punuar. Mu më ka ra fare pak për të punuar, të jem shumë i sinqertë...

**Anita Susuri:** Çfarë punë janë bo, për shembull?

**Gani Krasniqi:** Po aty ka patur, ka patur, kanë prodhuar ksi shporet Deligrad. A e din do shporet që kanë qenë Deligrad? Deligrad quhet të rrymës a të druve çka ta di unë. Po aty ke mujtë edhe armë. Po kanë prodhuar bojlera, kanë prodhuar të gjitha. Kanë prodhuar, tashti të ambalazhit për to, kanë prodhu shaha dekorativ. Për shembull, mu aty me m'çu... edhe nuk na ngucshin tani. Lexojshim. Po mora atë shah dekorativ. Ishte modeli tani unë e bona ni zbulim, ajo ishte vjedhë, nuk ishte zbulim po ata nuk e morën vesh.

Kur shkojsha në mramje e merrsha ni rub. A i ke pa ato lekat që janë të buta përdoren për tavolinë e sene a din? Edhe qashtu diqysh, e merrsha e lagsha ata edhe ia qitsha drunit, kornizës së drunit. E tash ajo e thithke ujin. Aty janë konë të gjitha llojet e brisqeve. Tash kur shkojsha unë veç e qitsha atë shabllonin, a din qysh shkojke briski, edhe e bojsha shpejt *trrak* {onomotope}. Ata nuk e dishin. Atëherë thojsha, "Unë jom mjeshtër". Edhe nuk ju tregojsha. Nuk ju kom tregu atë nuk e merrshin vesh. Po kështu ka qenë ajo do të thotë. Dalja pas burgut...

**Anita Susuri:** Qysh jeni kthy? A ka ardhë dikush me ju marrë a?

**Gani Krasniqi:** Jo, jo, s'ka ardhë me më marrë se na kanë lshu pak ditë para se me... p'e din ti, o bre kta janë... kur jemi ardhë në shtëpi...

**Anita Susuri:** E qysh? Jeni shku vet?

**Gani Krasniqi:** Me autobus. Me autobus, po. Po na lëshun katër vetë, erdhëm aty bashkë. Tani kur erdhëm, erdhëm në Bujanovc. Tani kishim aty shokë edhe tani me vetura. Na prunën në shtëpi, u shpërndamë. Ne na kanë pritë si hero atëherë...

**Anita Susuri:** Ka qenë viti '90-të apo?

**Gani Krasniqi:** '91-ta.

**Anita Susuri:** '91-ta.

**Gani Krasniqi:** Po. Jemi pritë si hero, do të thotë, osht' shkul kombi atëherë të na lirosh. Edhe ktu tani osht' bërë sikur që është bërë me UÇK. Njerëzit e UÇK-së që u prit UÇK-ja tani, tani, a din, dikush prej shokëve, kadale bre... tash, unë kujtojsha që pa mu ky popull s'po mujka me jetu edhe kemi ba gabime edhe te... se populli të ka respektu, të ka çmu, ta ka respektu sakrificën. E ktu nga pak shoktë kanë rrshitë unë t'u nejtë, se ky pa mu, paska nevojë. A din, dikush-dikush, se jo të gjithë. Natyrisht kemi gjetë realitetin e ri. Atëherë kemi gjetë kur dje ishim jashtë, figurativisht po thom, para '81-ten vetëm nëse thojsh, "Kosova Republikë", hijshe në burg. E sot majshe të punojsh për to, po natyrisht me mjete tjera. Këshilli i Pajtimit kishte bërë punën e vet, ishte çdo gjë kishte shkuar. Filloi ndërkombëtarëzimi, bota për të marrë vesh ku jemi. U organizu referendumi edhe ai bëri ni trandje. U bonë ato zgjedhjet, p'e din ato zgjedhjet e lira '92-tën...

**Anita Susuri:** Po.

**Gani Krasniqi:** Atëherë unë u pata bo pjesë. Bile jom konë... se ata janë konë zona, në secilnë komunë. E në proporcionalitet me popullatë kom qenë në mesin e pesë-gjashtë ma të votuar. Po atëherë na votojshin neve, ne të burgosur. Natyrisht, kom marrë Këshillin e Financimit, atë organizimin që e përmenda, paralelisht me të do të thotë s'jom shkëputë kurrë nga qytetari, kom njoftë qytetarin tim, çdo herë kom menduar. Ia kemi nisë. Kështu që, kur janë mbajtë zgjedhjet me 21 a 22 mars të '98-ës pas rastit Jasharaj, përkundër që kishim bisedu në forume edhe me Rugovën që s'bon.

Dega e Malishevës, se unë i merrsha të gjitha votat, po nuk u bojsha kryetar, e shfrytëzojsha këtë. Dega e Malishevës ka dalë botërisht. Krejt materialet unë ju kom dhonë. Ai o marrë me [shoqatën] Nënë Terezë, krejt bre ia kom kry puntë. Nëse ka dikush të drejtë në Malishevë, po edhe pa modesti se kjo nuk është për me thanë, se me LDK-në ka bo diçka, jom unë ai. Po jo për LDK-në, jo për Vetëvendosjen, jo për PDK-në, s'po di tash shumë po për mjete.

Ne jemi dalë botërisht, prej 15 vetëve anëtarë të kryesisë që kanë qenë, nantë janë konë të rreshtuar në UÇK. Ne jemi dalë botërisht. Krejt materialet ia kemi çu e sene, kemi dalë botërisht kemi thanë, "Lidhja", e ki me shtyp, "Lidhja Demokratike e Kosovës, Dega në Malishevë, në kohën kur ne ni pjesë të Kosovës terrorizohet, masakrohet po edhe rezistohet". Thu kjo është çmenduri, a din, janë këto çështje të cilat janë të gjitha për publikun.

Kur ka ndodhë rasti i, para kësaj, kur ka ndodhë rasti i Likoshanit, ne atëherë kem pasë jo njerëz të vullnetit të mirë çlirimtar po njerëz të ngritur 33 nën fallak që thojnë me gjuhën shqipe që kanë qenë. Dy autobлиндat e policisë kanë kaluar nëpër Malishevë. Njëra kishte qenë, masanena e kom marrë vesh, e policisë së Gjakovës, tjetra e policisë së Prizrenit. Ne kemi mendu te Jasharajt. Atëherë nuk e kishim mënyrën e komunikimit sikur tash, por ishte marrëveshja me Shaban Shalën, Jakup Krasniqin, a din, kështu për të shku fizikisht. Atë natë unë, si kanë shku ata, se mendojshim te Jasharajt,

menojsim që kthehem kurora ku osht' kur shkojsh për Rahovec. P'i din ato kurorat? Ata gurtë e mëdhej? Aty i kom pozicionuar deri nesër ora 10:30. Mendojsa që vijnë për të shkuar.

Do të thotë, paralelisht me punën legale, Këshillin e Financimit, Solidaritetit e të gjitha këto për ta majtë, për të kenë me qytetarin, ne kemi përgatitur. Dhe Brigada Imer Krasniqi që ka qenë Njësi Operativ "Lumi" në Malishevë, një, dy, tre. Brigada një, dy, katër dhe një, dy, pesë e Rahovecit edhe e Therandës që ka qenë Njësi Operativ "Lisi", Blerim Kuqi ka qenë. Ismet Tara ka qenë si njësite atëherë kanë filluar i Rahovecit. Ato janë brigada të dala nga jo unë, po ne. Unë kom qenë në krye të atij. Ne në ato ditë, unë kom shfrytëzuar Prizrenin, kom shfrytëzua Gjakovën, Rahovecin. Ato ditë ngase kom patur lidhje, kom shfrytëzua njerëzit.

Të gjithë ata tregtarë që tani u bonë Shtab të Prizrenit, do Liman Asllana, do, janë konë, do s'janë gjallë. Të gjithë ata, na jem, ata kanë kry punën veç kishim njerin, kishim njerin që mbante lidhjen, kërkesat, "Duhet kjo, duhet kjo". Ne kemi filluar prodhimin e uniformave në Malishevë në atë kohë në Malishevë, në kooperativën... uniforma jo për ushtarë të Malishevës, po uniforma, në bashkëpunim edhe me njerëz, ekipin e rrobaqepësisë e kemi pasë nga Gjakova në krye me ni mësuese të rrobaqepësisë, Dritë Vula. Aty ka qenë komplet ekipi.

Kemi filluar prodhimin e emblemave tipike origjinale, i kom të shkruar. Ni njeri nga Prizreni na ka pru atë si vegël çka po di e gjatë diqysh {shpjegon me duar formën e shkopi}. Tipike e Prizrenit, prej Turqisë na ka pru. Ne Malisheva kemi filluar prodhimin e këpucëve "Solidi" në Suharekë. Ka pru Blerimi, Blerim Kuqi e ka pru atë pronarin e "Solidit". "A ka mundësi?" "Po", më tha. Më thojke, "Duhet kallapët". "Ti tregom shoq a ka mundësi?" "Po". "Çka duhet ti i bën, kjo një, edhe tregoma sa osht' çmimi i prodhimit i këpucëve tipike ushtarake?" Çmimi i këpucëve tipike ushtarake ka qenë 26 marka. Thashë, "Fillo". Kur i kom thanë, fillo, ai ka menduar, "Qysh me fillu, duhen lekët, ata kallapët", çka po di, "materiali". "E dëgjo", thashë, "ky të rrin mrapa me lekë", Blerimi, "çka duhet ti i tregon".

## Pjesa e Katërt

**Gani Krasniqi:** Në fund kemi filluar prodhimin, kjo a din, gjana që nuk i dijnë, nuk i din opinioni publik po do t'i din kadalldale. Osht' koha që... te autoblindave. Ideja ka qenë e Ukë Berishës nga Theranda. Kishte punuar në Kroaci, në Rijekë të Kroacisë në port. Kur Kroacia para se me hi në luftë si republikë, si shtet, duke prodhuar autobinda kishte marrë modelin, ma bjen në Bubël të Malishevës. Tri copa i kemi pasë të prodhume. Autobindat e NATO-s tash, veç të jemi... autobinda që... e katërta ka qenë duke u prodhuar.

Aty ka qenë ekipi me të gjithë inxhinierët. Llamrinën na kanë pruar tregtarët prej Prizrenit, prej Gjakovës. Valla, s'di, e merrshin në Brajë më doket, çka po di unë. Edhe i veshim, jo i vesha unë po i veshim me guma ata që ishin. Kjo ka qenë në kohën kur ka qenë Malisheva zonë e lirë. Zonë e lirë është

shpallë, jo qysh thojnë tash, a din, se s'po muj m'i thonë do gjëra. Jo Gryka e Llapushnikut sene, po Gryka e Llapushnikut po po aksioni i parë, aksioni i parë i organizuar mbi policinë ushtarake osht' marrë që thuhet frontal me 26 prill në Balincë të Malishvës. Pse osht' marrë?

**Anita Susuri:** '98-ën?

**Gani Krasniqi:** '98-ën. Nga aty, Orllat, e dini aty në Orllat ku kthehesh për Malishevë, Orllat-Kijevë. Pak para se me shku në Kijevë, se në Kijevë kanë qenë njësitë elite. Ajo u konë në kontrollin tonë. Pse osht' marrë ai aksion? Unë e kom patur, në plan e kom patur ni informatë po nuk kishte qenë ashtu. Unë e kom pasë ni informatë që Adem Jashari ka sulmu ni patrollë të policisë në Balincë, osht' vendi. Qëllimi im ka qenë... po, jo Adem Jashari s'kishte qenë, masanej e kom marrë vesh. Por, për ta përtrirë atë aksion, unë hala visha në Prishtinë. Këshilli, ku jemi. Po, Këshilli i Financimit ka qenë ktu dikund. Kjo rruga që shkon për Gërmi.

Unë kom patur lekë, para, se qita [Selatin Novosella](#) e patën bo Këshillin e Solidaritetit, Këshilli i Financimit. Ismail Kastrati, Mehmet Hajrizi kta i kom se kom qenë pjesë e tina. Unë veç ja u bijsha faturat, veç ja u bijsha faturat. I bojsha, shembull, 70-80 mijë euro m'u dufshin, a din, po thom euro se atëherë marka kanë qenë. Miell, vaj, detergjent ia lijsha faturën për me ardhë ni kontrollë. Kta m'i jepshin lektë e thata. Du të them, unë e kom patur këtë plus unë, kta që thojnë, unë kom marrë para te Bujar Bukoshi. Bujar Bukoshi s'po del me thanë, po unë kom dhanë, i kom dhanë botërisht Bujar Bukoshit. Se unë jom taku me Bujar Bukoshin, Isa Mustafën tri ditë, '98-ën, në gusht të '98-ës. Pak ditë para se me u bo ofanziva, me 19 unë kom shku për t'u takuar.

Pse osht' bo aksioni? Të kthehemi. Duke menduar kështu unë vi kur... vi ktu. Skender Kastrati ka qenë njeri i afërt i Bacës Adem. I dënuar '74-tën me të. Osht' njeri i mrekullueshëm, dilke, s'guxojke me bisedu brenda, dilke, "Çka i kemi puntë?" "Si osht' Baca Adem?" "Tmerrësisht i shqetësuar". "Çka ka?" "Për këtë". "Bacë", po thotë, "Drenicën e lanë vet prapë", a din se që kanë shku... t'i mbajtën zgjedhjet knej. Thashë, "Thuj Bacit Adem ka thonë Gani Bej", atëherë më thojke Gani Bej e pas luftës më thojke kryetari jem. "Thuj Bacit Adem, pi duhon llullë lirisht s'e lojmë vetun", thashë, "tregoj", thashë.

E tash unë e kisha ndërmend për atë, tash e kom ngut procesin. Me 26 prill kur lshohesh për me shku për Pejë kur dahësh për Malishevë ajo rruga e Prizrenit, a din që shkon për Prizren, tani që ndahet për me shku për Pejë. Kur të bijsh poshtë, si të bish poshtë tani osht' e preme e çume naltë, si gjysmë hanë aty. Aty i kom pozicionuar dikund 24-25 vetë. Jom shku i kom marrë edhe te njësitë i Jakupit, qiky Ferat Shala ka qenë komandant. A din, duke qenë shokë e sene unë jom shku i kom marrë pesë vet, a din, jem aty. Ka qenë, atëherë, ni marrëveshje kështu se s'kishim hala kërkund që mos me i sulmu ushtrinë. Që e preke ushtrinë, ti... i jep kështu urdhër, i sistemoi në gjysmë harku, kisha vëzhguesit atje.

Unë kom qenë pjesë e aksionit, e kom kontrollu aksionin. Osht' bërë në, dua ta them se është me rëndësi për ta thënë, se çdo gjë çkado që kemi bë ne e kemi pasë borxh që jemi gjallë. Ata që nuk janë,

do të janë e janë ma gjallë se ne. Imer Krasniqi është dëshmor i parë i zonës, a e ke pa ajo kolona që del, që e përdorin nëpër spota, ajo është vorrimi i tij. Imer Krasniqi ka qenë njeri ma i afërt i imi. Ka qenë njeri që ka punuar me mua, do të thotë, ka patur armë nga '94-ta. Jo armën e babës e të gjyshit, po armën... ju po mendoni edhe për këtë UÇK që... armë.

Imeri ka qenë i pozicionum nga Kijeva. Ky ka qenë Hysni Kila edhe ni Vllaznim Kryeziu ka qenë në këtë pozicionin si gjysmë harku. Ka qenë urdhëri nëse vijnë nga knej, se me dylbi i kemi patur në dy pozicionet për kontrollë. Nëse vijnë nga knena, se ata vinin po shumë të kontrolluar se kishim kontrollë. Të sulmohet sendviq. Të sulmohet bishti, kur të sulmohet bishti, koka për ta futë kha. E njejtja gja. Tash lodhet Imeri, po dua ta them për Imerin këtë. Thotë, kta që e ka treguar masanej, thotë, "Baci Gani, vallai ushtar, çka të don për që ta pret..." tash prej orës para 4:00, katër pa ni çerek, mëngjes herët deri në 10:30 ka qenë përafërsisht. "Del çka të del, ka me ia çu bereqetin".

Kjo që dua ta tregoj, dua ta tregoj shpirtin e çlirimtarit të vërtetë. Kur vjen kolona e ushtrisë edhe kto ceradat e hapura. Tash ky s'ka pasë me sulmu... kur e sheh, që nëse ia sulmojnë bishtin ky me ia sulmu krytë. Kur e sheh ushtarin e ri, a din, që e ka pasë dulbi, i ri, i pshtetun për pushke hjekë dorë, nuk shtin. A p'e sheh çka osht' shpirti? Tani s'vanohet shumë kohë vijnë ni pishgaver edhe dy autoblanda të policisë aty. Pishgaveri osht' shkri, ni autoblandë ka mbetë, njëra ka depërtuar, ka qenë aksioni i parë. Nga aty ka qenë, nga 26 prilli ka qenë nën kontrollë ajo rrugë edhe ka qenë ajo zona e lirë e nënkuptuar ashtu që ka qenë ajo zona e lirë e Malishevës.

Kësaj ia ka parapri, tani, nuk osht' bre qashtu se e ke pa do qysh japin, ne qysh dijmë. Aty i kemi pasë të gjitha takimet. Të gjithë njerëzit ambasadorët, këshillet europiane, ku ta di unë, kemi pasë takime. Aty kishte për të ardhë [Richard] Holbrook për vizitë. Ardhja e Holbrookit i jepke ni garancion të asaj, se e pa realitetin, se ndryshoi nga grupet terroriste nga [Robert] Gelbard në lëvizje çlirimtare ma demokratike. Dojke me pa... po kur vjen në Prishtinë ktu, qysh jemi ne. Nuk u bojshin, ky donte t'i tubojë bashkë, nuk janë bo bashkë, jo ky, jo ai, p'e dini.

Para se me ardhë Holbrook, ka ardhë qita këshilli qita [Albert] Rohana, ky i Austrisë, Wol..., s'po më kujtohet po kanë ardhë. I kena pritë unë edhe Kadri Veseli. Prej Duhlës, se ti kalon anena, prej Duhlës deri në Malishevë, çdo 50 metra... në çdo 50 metra ka qenë ni ushtarë me qëndrim gaditu. Kjo është një. E dyta kanë qenë tri vetua, xhipa, me targa të UÇK-së në përcjellje. Ni para, ni mrapa, ni në mes. Delegacioni që e kemi pritur. Unë atëherë kom qenë, domethonë, pjesë e shtabit. Kom qenë drejtor i drejtorisë për administrim civil që patëm ra mrapa ma vonë. Kom bërë raportin, popullata çka mundët me ndodhë nëse s'o rezerva, kjo, kështu, kështu.

Kadriu ata e dijsin që osht', nuk e dijsin po ata e kanë pasë informacionin të shërbimit do të thotë ata komunikojshin, kryesisht komunikojshin me mu. Pushtetin civil, e ke ti parasysht. Kështu edhe thanë, "Ne erdhëm parapërgatitje se prisni sot pritni edhe presim që të vjen zoti Holbrook". Edhe ne ishim përgatitë i kishim rregullu ato, janë inxhizimet e të gjitha. Natyrisht Holbrook, s'un u mor vesh

me të, prej ktu ka fluturuar dhe ka shkuar për Athinë. Tha, “Shkoi në Beograd”, tha, “të flas me Millosheviqin, me Serbinë. Kur vi ktu du me shku, pak karikaturën, du me shku njiqind kapixhika, s’kom kohë me u marrë me juve”.

Kjo do të thotë është dëshmori i parë i ramë në zonë është njëri më i afërt i imi, jo vetëm i idealit po edhe i mbështetjes edhe i gjakut është Imer Krasniqi. Varrimin ia kemi bërë me nderimet ma të nalta si shtet, domethonë jonë të inçizume. Aty janë bo qitjet e para. Bile sikur të mos isha unë aty as atë inxhizim nuk e kishim, e ke parasysh. P’e shoh ni komandant Abazi thojshin kamaraman ka qenë, i Pejës është dikund Abazi me këtë Nuhijen. Po i thom, “Ej”, tha, “Luli”, “Kush bre Luli?” Unë isha në turmë me Kadrinë, “Çka bre Luli?” “He Baci Gani?” “Çka ju ke thanë ktyne?” “Po unë se marrë...” “Kond more s’e merr ti, xhiro more ec ti”. Osht’ xhirruar. Do të thotë, e kemi dhuratë. Ai e merr përsipëri... aty kanë qenë tani qitjet e nderit për herë të parë. E pamja është bërë tamon me roje nderi me krejt. E lëshun krejt kombi, ishte...

Natyrisht ishin të gjithë ato, ishin ngritjet, rrximjet, nxëmjet në thu. Por, megjithatë arritëm natyrisht çmimi gjithsesi, çmimi na takon neve, na ka taku neve se neve na mungon liria. Tani e gëzojmë sot por ktu është pjesë secili sa ka dhënë. Lumi ai që ka dhanë ni pjesë të obligimit. Po natyrisht ka edhe komuniteti ndërkombëtar, natyrisht ka interesin e tina. Por, falë interesit çmimet ishin. Ne jemi ata që kur kemi biseduar kemi thonë, “A 150 mijë dëshmorë veç të jenë”. Kështu kemi biseduar. Edhe jemi në këtë realitet, në realitetin e pas luftës.

**Anita Susuri:** Po du paraprakisht me ju pytë edhe për përfundimin e luftës, ku keni qenë? Familja ku ka qenë?

**Gani Krasniqi:** Ofenziva e dytë është detyruar kuptohet, familjet e tona të gjitha, pjesa e madhe, ma e madhe kanë dëbuar ose i kemi marrë ne në mbrojtje edhe na kanë ndihmuar drejtpërdrejt në të vërtetën. Bashkë me familjet e popullit tim ka qenë edhe familja ime. Familja jonë e gjanë. Kemi qenë si familje... do të thotë mashkullin ma të madh e kanë pasë 13 vjeçar me veti, krejt kanë qenë gra e fmi. Mbi 60-70 t’u i llogaritë të axhës e kështu. Nejse, ne kemi patur gjithë kemi qenë të përfshinë në luftë, por kemi patur edhe pjesën tjetër që kemi patur jashtë.

Nga jashtë kanë ardhë edhe të familjes, kanë ardhë edhe djemtë. Dy nga ta. Unë kom kërkuar vazhdimisht nga pjesa që janë jashtë që ata të rrijnë, jo te të mitë po ata të rrijnë të na ndihmojnë nga atje vetëm ne të kemi logjistikë. Pjesa jonë ma e dhimbshme, pjesa e gurbetit, vërtetë ajo ka qenë edhe para luftës edhe pas luftës ka qenë logjistika jonë por kanë qenë edhe pjesë e luftës. Kemi edhe dëshmorë që kanë rënë... fundja edhe ata e kanë pasë borxh po... nashta muj me thanë, “Pse ti ke ktu e s’e kape pushkën, e pse ti ke prej Anglisë?” për shembull. Përfundimi i luftës, do të thotë, 15 ditë para lufte kom patur kërkesë për të shkuar në Tiranë, nga drejtuesit e luftës me selame.



Unë duke menduar se unë kom qenë nifarë katalizatori, a din nuk i kom kqyrë shumë këto, përafres kom qenë. Duke menduar që ia dhanë haku naj sen po atëherë më kishin pas ftu, kur shkova e mora vesh që... kam shkuar në këmbë deri në Odër të Tetovës. Ishte shumë me rrezik se atëherë nuk kalohej anej se më ka ra shpesh me kalue kufinin edhe nga Tropoja edhe nga Hasi. Njiherë kam kaluar edhe andej, do të thotë nga Opoja. Po atëherë na osht' dashtë ktu të shkojmë bjeshkëve të dalim te Luboteni tv bijmë atje pastaj atje i falsifikum dokumentat me taksi edhe shkum.

Kur shkum në Tiranë ishte shtabi, ishte ajo qeveria e përkohshme. Po më thojnë... thashë, "Faleminderit", për të kenë pjesë e qeverijes. Do të thotë, kom hyer tani, tani veç fillunë ndërhyrja e, e, kombëorisë do të thotë marrëveshja e nënshkrune ktu në... me ato 15 ditë kom qenë atje. Jo 15 ditë se dikund pesë-gjashtë ditë i kom bo duke shkuar, se a din flej ktu, flej atje, flej atje. Tani kom parë si kemi ardhë ktu ju kemi përvëshë punës. Dihet se Malisheva ma s'pari nuk ka qenë komunë, ne jemi organizu si komunë në atë paralelizmin tonë, por faktikisht nuk ka patur, s'ka patur asgjë. Malisheva s'ka patur kumeditë çfarë infrastrukture po atë që ka patur Malisheva s'ka pasë fshat që s'ka qenë i djegun, s'ka pasë fshat që s'ka qenë i damtum. Ka qenë shumë i damtum.

Atje nuk pranova. Dul propozimi e pranova me qef për ta marrë për ta drejtuar qashtu qysh ishte. Ia kemi nisë në kooperativë tre-katër muj kemi punuar, krejt kështu në baza vullnetare po s'ishe... deri kur ka qenë i zoti [\[Mark\] Baskin](#) në këtë [kryesi] regjional, tri-katër mledhje i kanë majtë kur më kanë thirrë mu. S'isha kryetar, kur e marrë vesh shkoj i paftuar. Aty ku osht' ni pjesë e administratës, a din, si bankë që ka qenë përpara aty ni sallë e madhe është. Kur i kanë kryer, ka ardhë tema e pushtetit, jam çu e kom marrë fjalën pa... edhe i drejtohem, aty çka s'kishe bre, kishte shërbime të ndryshme të KFOR-it, të UNMIK-ut çka s'kishe. Ai Baskin [kryetar] regjionali ai kish qenë si me konë serb. Ka qenë i Finlandës anena, serbisht folshim me të.

Ju kom drejtu shqip, "Unë", thashë, se e mora fjalën, veç u nalshin po më kqyrin, s'e dishin kush jom. "Une", thashë, "jom Gani Krasniqi, vi nga Malisheva", veç po më kqyrin, "jom", thashë, "kryetar i Komunës së Malishevës. Asaj që as ju nuk e njihni..." Ekrem Rexha se e kom patur nime Ekremin gjatë luftës kontakte veç kur ka bërtitë, "Të lumtë Baci Gani!". Edhe ju drejtohna, thashë, "Më vjen keq, turp për kta kolegët e mi, kryetarët e Komunës ka qenë ky Kadria i Kushtetutës veç planc është", se i njoh a din flas kështu. Ofendon, nuk ofendoj po veç planc është. Bile i thojshim, "Rri qatje në Prizren na bon naj lidhje", s'rrinte, po s'osht' me rëndësi.

Janë konë qito komunitat, ni Agim Thaçi e kom shokë ata edhe në luftë ka qenë i Rahovecit. Ka qenë Sharri, s'ka qenë Uka atëherë kryetar. Ka qenë ni msus i Suharekës Isufi, Isuf Krasniqi i luftës ka qenë. Ka ardhë prej... po kryesorja kur u kry thashë, "Jom kështu", thashë, "le të çohet le të flet për këto pika dikush. Arsimi *tak, tak, tak* {onomotope} unë kom organizuar këtë..." pas dy dite ia kom çuar, kisha përgatitë historikun krejt të dhanat, qysh, tek. Do të jetë thashë, "Komuna e Malishevës është komunë" edhe tha, "Na keni imponu edhe e bom". Kështu që, zgjedhjet e para konkurova për këshill, s'ma merrke menja si i pavarur.

Kom pasë hy ato dy vjet a sa zgjatën. Nuk mujsha me e dhanë kontributin se të jep çka të dush kur nuk e ki votën jep propozim, voton, s'shkon, s'ki çka me bo. Tani erdhën zgjedhjet tjera atëherë pat' hupë do të thotë, se kta patën hi shumë rend. Vërtetë kishte se Malisheva ishte pjesë e luftës, bile aty do të donte të fitonte sikur në Skenderaj, a din, në Drenas, në Shtime, ku ka qenë. Tani kur e bona qeverinë e përbashkët, e prunën ktu thashë, "Faleminderit që doni..." Kom shku, s'kom qenë në Partinë Demokratike po tani natyrisht jom pa, kom marrë qatëherë 2003-tën çka ke, pesë vjet ka zgjatë ai mandat.

Kom qenë kryetar me mandat të PDK-së, natyrisht unë kom dëgjuar me vesht e mi, veç unë kom dëgjuar, veç unë e kom dëgjuar Hashim Thaçin, kryeministrin e atëhershëm, jo s'ka qenë kryeministër, kryeministër ka qenë i përkohshëm, duke thënë, "Autoriteti i Partisë Demokratike është kryetari i Komunës së Malishevës", jo Gani Krasniqi po, "Baci Gani Krasniqi". Po po aty nuk ka patur, s'ka patur, aty s'ka patur me u bo parti politike. Aty ka patur punë, ka patur përgjegjësi, s'ka pasë aty me u sillë kta kanë rrrshitë, a din. Unë e kom pasë nifarë marrëveshje të nënshkrune, po për dy mandate. Kom qenë shumë i interesuar për ta patur edhe ni mandat, nuk deshtën se ishte puna e privatizimit, s'mujshin, "Jo s'po ta vazhdojmë", "Ditën e mirë!"

Po edhe kur kom qenë kryetar unë kom mbështetë projektin e Lëvizjes Vetëvendosjes. Diçka që dua të përmend, unë kujtoj, jo kujtoj po ia vlen se osht' pjesë e jetës time, pjesë e jetës dhe përpjekjeve të mia, të familjes, të brezit e kështu me radhë. Ne si lëvizje kështu kombëtare që kemi qenë, kur osht' punuar, kur është thënë, "Kosova Republikë", është menduar për republikën e shqiptarëve në Jugosllavi, të gjithë. Natyrisht aty kanë qenë të përfshirë, kemi edhe dëshmorë, jo të shqiptarëve se në Jugosllavi po edhe të Republikës së Shqipërisë që kanë ardhë vullnetarisht. Por, mbështetjen me fillimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga ndërkombëtarët e kishim nga kufijtë administrativ si element konsitutiv që ishte Kosova. Ktu ju mbështesim.

Tani u dashtë, se atëherë kanë qenë zona të ndërtuara me veprimtarinë tonë. Për zona me ia fillu me Kosovë, shqiptarë në Maqedoni, në Luginë, në Preshevë e kështu me radhë. Po tani ato u dashtë natyrisht, ata thonin, "Hyni anej, nuk ju mbështesim". Kështu që, pas luftës çlirimtare në Kosovë ishte ai pesë kilometërshi si zonë neutrale. Bashkëveprimtarët dhe bashkëluftëtarët tonë të Luginës fillunë për të ngritë kokën për të drejtat e tyre atje. Natyrisht unë kom hy disa herë, jo si ushtar po kom hy disa herë për të parë dhe i kom mbështetur. I kom mbështetë me logjistikë, ata s'e kom mshefë kurrë. Shoktë e politikës të mi e të luftës atëherë edhe kanë pengue, është çështje e tyre, e dijnë ata. Se mbështetjen nuk e ke pasë nga komuniteti ndërkombëtar për atë pjesë megjithatë.

Në 2001-tën ishte Ushtria Çlirimtare Kombëtare natyrisht sidomos zonën e Kumanovës e kanë majtë djemtë e tonë të Llapushës, ni pjesë të Deçanit. Aty kanë qenë edhe familja. Aty më ka ra djali, Labinoti, Labinot Krasniqi me 6 qershor, 2001. Siç ka ra Visar Krasniqi para Labinotit me 2 qershor, 2001 dhe siç ka ra Ilmi Hoti i fshatit aty, djali i shokut, bashkëmoshatarit tim, bashkëveprimtarit tim,

bashkë të burgosurit tim që ka qenë i organizuar. Por, tani nuk është në jetë. E kanë majtë pesë vjet në burg, Hisni Hotin edhe ajo frymë, po ai pat' dekë tani prej aksidentit. Përndryshe, janë edhe dajtë e Jakup Krasniqit. Që edhe në atë pjesë shqiptare siç shqiptarët që kanë dhanë për lirinë në pjestë e tjera edhe aty kemi do të thotë.

Në luginë e kemi Agim Elshanin nga Gucati i Malishevës, po kemi edhe pjesë të tjera. Po po du të thom edhe aty pos me efektiv e me numër duke nisë nga familja po edhe me logjistikë po edhe me instruksione të ndryshme, ngase Aliu ka qenë pjesë e oganizimit tonë. Hisni Shaqiri, deputeti nga kuvendi në luftë kishim kontakte po edhe kemi hyrë për të ndihmuar jo kumeditë çka. Por, megjithatë atë status që ka, sado pak të avancuar shqiptarët atje e këtu, është, aty e ka hisen edhe kjo pjesë shqiptare që e ka pasë borxh e ka tani edhe familja ime, e ka hisen edhe puna ime si të gjithë shqiptarët tjerë.

**Anita Susuri:** Zoti Gani, nëse s'keni edhe diçka me shtu për fund ju kisha falendëru shumë edhe për kontributin edhe për intervistën edhe për kohën sot.

**Gani Krasniqi:** Unë vetëm edhe ni gjë do ta shtoja...

**Anita Susuri:** Po.

**Gani Krasniqi:** Që lidhet me aktualitetin e sotëm. Unë e thashë në ni mënyrë pak më herët shumë e natyrshme por edhe e dëshirueshme po t'ishte për mu, ai brez që identifikohet si brez që ka çu proceset përpara, ka bo përgatitjen edhe brezi që ka bërë luftën që identifikohet me çlirimin e Kosovës, të kishte arritur t'ia jap kuptimin asaj lirie. Kjo ka qenë edhe e natyrshme edhe dëshira ime. S'po di... për fat të keq tonin, nuk u treguam ata, atë gatishmëri edhe për të luftuar edhe për të sakrifikuar për lirinë u koritëm nuk u sakrifikuam për t'i dhënë kuptim lirisë.

Kështu që, parashtrohet pyetja mund t'thotë dikush, cila do t'ishte dëshira? Dëshira do të ishte ajo, në atë dëshirë do të ishte dëshira ime. Unë sot jam gjysh, thashë, dhjetë herë. Unë kom 72 vjet, do t'i mbushi në fund të vitit. Unë kom detyrime dhe obligime ndaj familjes, ndaj familjes me kombin sado që të jem gjallë. Por, natyrisht shumë do të dëshiroja. Mu nuk më pengon mosha se jom pjesë aktive. Unë nuk thom partia ime, kush më njeh mu më njeh kështu, jo nëpër parti. S'po di qysh me thënë. Po nga vet fakti se ti je deputet në Kuvendin e Kosovës. Po? Nga cila parti je? Nga Lëvizja Vetëvendosje. Unë nuk jom ndje i fyer pse jom në Lëvizje, s'po di qysh me thënë.

Po, po, duke qenë prind dëshmori, duke qenë familjar dëshmori, Imeri është gjaku im po gjaku im është edhe ata dëshmorët tjerë, se ata të frymës time janë. Shumë bre do të kisha dëshiruar edhe ka patur mundësi forma për të qenë pjesë e kontributit po ni formë tjetër. Për t'i qitur bre kto në letër, për t'i thënë, për t'i publikuar, kjo, kjo, kjo, se ne kështu jemi frymëzuar duke dëgju lahutën e çiftelinë. Tregimet nga babët tonë me me qelshin kaq {shpjegon me duar e trashësinë} analfabetë po kështu

jemi frymëzuar. Por shumë do t'kisha pasë dëshirë edhe dëshirë do të ishte e natyrshme edhe e kemi merituar edhe si popull po edhe ne.

Unë mendoj kur të vjen dita për të shku për të votuar t'ia qes votën kujna të du, kënd të ma merr menja po jo të jem pjesë aktive unë të shkoj të kërkoj t'më qitet vota. Me këtë dua të them që angazhimi im politik është pikërisht se jemi në situata edhe gjithnjë pas 20 e sa vjete edhe në udhëkryq. Pas një fitore... s'jemi bre ne në terezi, o e kemi hjekë ni Serbi nga këtu me ushtri, me polici, me ni supër fuqi e rajonit ka qenë. Gjithmonë falë sakrificës edhe të gjithë, falë edhe mbështetjes të ndërkombëtarëve. Nuk është që kemi patur por edhe kemi mundur po edhe kemi mundur ta hjekim e jo të gjindemi në udhëkryq.

Plus, duke patur sakrificën garancë kryesore, luftën e njohur ndërkombëtarisht, duke na ndihmuar dhe bërë pavarësinë në 2008-ën, duke na njohur pavarësinë, duke ankimuar Serbia me të padrejtën tonë, duke vërtetuar gjykata ma e lartë ndërkombëtare GJND-ja, se janë në të drejtën e tyre shqiptare ne edhe gjithnji gjindemi në udhëkryq. Kjo është edhe ajo që unë jom edhe është e dhimbshme. Edhe nuk është e dhimbshme në raport me dëshirë se s'jemi ku duhet të jemi. S'osht' e dhimbshme në raport me me atë që na takon, meritojmë si popull. Po është e dhimbshme në raport me atë që kemi mundur të bëjmë e nuk e kemi bërë. Kjo është e dhimbshme. Për këtë jam edhe kjo nuk do të na falet.

Si brezat të jenë mirënjohës për secilin, çdo gjë që kemi bërë, kurdo që kemi bërë, për besë do ta kenë të drejtën e tyre dhe do të na thojnë edhe për kto që qëta nuk ua patëm borxh bre. Ani bre. Ju ardhë liria, t'i jepet kuptim lirisë, e hongrët lirinë. Po sidoqoftë mos të përfundon kjo me pesimizëm, unë nuk kom patur, unë, kur thom unë mendoj gjithnji me brezin tim edhe kur ni vrimë të vogël, ni pus, ni bunar të thellë është pa ni vrimë shumë e vogël e dritës e kom pasë do besim me të drejtën. Po për të drejtën duhet punuar, duhet rrezikuar për ta bërë edhe e kemi. Unë kom besim në perspektivën e shqiptarëve edhe s'ka agjendë që e nalë. Por ne përgjithnji do të jemi fajtor. Por s'ka që e nalë perspektivën shqiptare. Kjo osht'.

**Anita Susuri:** Faleminderit shumë.

**Gani Krasniqi:** Të lutem, shumë.